



MENAXHIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMATAVE

Doracaku 3

Materiali në këtë punim është i mbrojtur me të drejta autoriale. Kopjimi dhe/ose bartja e pjesëve të kësaj vepre ose veprës së tërë pa leje mund të jetë shkelje e ligjit në fuqi. KNF inkurajon shpërndarjen e punës së saj dhe zakonisht jep leje për riprodhimin e pjesëve të veprës menjëherë, dhe kur riprodhimi është për qëllime arsimore dhe jo komerciale, pa pagesë, me atributet dhe njoftimet që mund t'i kërkojmë me arsye. KNF nuk garanton saktësinë, besueshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së përfshirë në këtë punim, ose për konkluzionet apo gjykimet e përshkruara këtu dhe nuk pranon përgjegjësi ose detyrim për ndonjë lëshim ose gabim (duke përfshirë, pa kufizim, gabimet tipografike dhe gabimet teknike) në cilëndo përmbajtje ose për t'u bazuar në to. Kufij të, ngjyrat, emërtimet dhe informacione të tjera të paraqitura në hartë në këtë punim nuk nënkuptojnë ndonjë gjykim nga ana e Bankës Botërore lidhur me statusin ligjor të ndonjë territori ose miratimin apo pranimin e kufijve të tillë. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë vëllim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore apo të qeverive që ata i përfaqësojnë.

Përmbajtja e këtij punimi është vetëm për qëllim të përgjithshëm informativ dhe nuk ka për qëllim të përbëjë këshilla juridike, të letrave me vlerë ose të investimeve, mendim në lidhje me përshtatshmërinë e ndonjë investimi ose kërkesë të ndonjë lloji. KNF ose bashkëpunëtorët e saj mund të kenë investim në disa prej kompanive dhe palëve (përfshirë ato të përmendura këtu), të ofrojnë këshilla ose shërbime të tjera për to ose të kenë një interes financiar në to.

Të gjitha pyetjet e tjera mbi të drejtat dhe licencat, duke përfshirë të drejtat subsidiare, duhet të drejtohen në Departamentin e Marrëdhënieve të Korporatave të KFN, 2121 Pennsylvania Avenue, N.W., Washington, D.C. 20433.


Korporata Financiare Ndërkombëtare është një organizatë ndërkombëtare e themeluar me Marrëveshje ndërmjet vendeve anëtare të saj dhe është anëtare e Grupit të Bankës Botërore. Të gjithë emrat, logot dhe markat tregtare janë pronë e KFN-së dhe ju nuk mund të përdorni asnjë material të tillë për çfarëdo qëllimi, pa pëlqimin me shkrim të KFN-së. Përveç kësaj, "Korporata Financiare Ndërkombëtare" dhe "KFN" janë marka tregtare të regjistruara të KFN-së dhe mbrohen me ligjin ndërkombëtar.

© Korporata Financiare Ndërkombëtare 2014. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

2121 Pennsylvania Avenue,
N.W. Uashington, D.C. 20433
www.ifc.org

Watts dhe Associates, Inc. ("Watts") dhe Instituti Ndërkombëtar për Menaxhimin e Rrezikut të Bujqësisë ("INMRRB") janë bashkë-autorë dhe së bashku kanë interesin e plotë pronësor në përmbajtjen që e kanë krijuar në materialin që e përmban ky dokument ose prezantim. Interesi i pronësisë e përfshin të gjithë përmbajtjen, e cila përfshin, por nuk kufizohet në teknologjinë, teorinë, konceptet, idetë, strukturën organizative ose çdo përmbajtje tjetër në çfarëdo forme që mund të paraqitet nga dokumentet me shkrim ose prezantimin në të cilin gjendet materiali pronësor. Materiali pronësor i përfshirë në këtë dokument ose prezantim i nënshtrohet marrëveshjeve të konfidencialitetit që ndalojnë botimin, ekspozimin ose shpalosjen e përmbajtjes së pronarit, tërësisht ose pjesërisht, në çdo formë ose media, për çdo person ose subjekt që nuk është i autorizuar nga Watts ose IARM për të parë, shqyrtuar ose për t'u angazhuar në ndonjë diskutim në lidhje me të. Ky material mbrohet me ligjet e SHBA-ve dhe ato ndërkombëtare, nuk mund të kopjohet as tërësisht as pjesërisht dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përcillet nga cilido person i autorizuar të ndonjë palë e tretë që nuk është autorizuar më parë për ta marrë përmbajtjen e këtij materiali. Informacioni në këtë publikim paraqitet në mirëbesim për qëllime të përgjithshme informacioni, dhe as Watts as INMRRB nuk duhet të mbahen përgjegjës për ndonjë nga informacionet e paraqitura këtu. Ky material nuk pretendon të shërbejë si prezantim i plotë i çështjeve të diskutuara këtu dhe nuk duhet të përdoret si bazë për marrjen e vendimeve komerciale.

© 2014 Watts dhe Associates, Inc. dhe Instituti Ndërkombëtar për Menaxhimin e Rrezikut të Bujqësisë. Të gjitha të drejtat e rezervuara."



MENAXHIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMATAVE

NË PARTNERITET ME DONATORËT



GRUPI I BANKËS
BOTËRORE




Tabela e përmbajtjes

1.0.Hyrje.....	7
2.0. Përdorimet e të dhënave.....	8
2.1 Zhvillimi i programit	8
2.1.1. Planifikimi strategjik	9
2.1.2. Qeverisja e sistemit.....	9
2.1.3. Koordinimi i funksioneve të biznesit.....	10
2.1.4. Raportimi financiar dhe llogaridhënia	10
2.2. Dizajni i produktit.....	10
2.2.1. Kërkesat për të dhëna për vlerësimin empirik	10
2.2.1.1. Kombinimi i të dhënave duke përdorur procedurat Bootstrapping	11
2.2.2. Kërkesat për të dhëna për vlerësimin parametrik	11
2.3. Menaxhimi i programit.....	11
2.4. Vlerësimi i programit.....	12
2.5. Dokumentimi	12
2.6. Politika publike	12
3.0. Nevojat për të dhëna	13
3.1. Nevojat fillestare për të dhëna	13
3.1.1. Nevojat për të dhëna për sigurime individuale.....	14
3.1.1.1. Të dhënat e sigurimeve të rendimenteve individuale.....	14
3.1.1.2. Të dhënat e sigurimeve të të ardhurave individuale.....	14
3.1.2. Nevojat për të dhëna për sigurime sipas vlerës së përafërt.....	14
3.1.2.1. Të dhënat e sigurimeve të rendimenteve sipas zonës	15
3.1.2.2. Të dhënat e sigurimeve të të ardhurave sipas zonës	15
3.1.2.3. Të dhënat e çmimeve të sigurimeve	15
3.1.2.4. Të dhënat e produktit të indeksit të motit	16
3.1.2.5. Të dhënat e imazheve satelitore.....	16
3.1.3. Nevojat për të dhëna për sigurime të marzhës	16
3.2. Nevojat për të dhëna operacionale	17
3.2.1. Nevojat funksionale.....	17
3.2.2. Nevojat informative	18
3.3. Kërkesat për të dhëna të risigurimeve	18
3.3.1. Dorëzimi i risigurimeve	18
3.3.1.1. Dokumentacioni aktuarial	19
3.3.1.2. Administrimi i produktit	19
3.3.1.3. Nënshkrimi	19
3.3.1.4. Korrigjimi i humbjes.....	19
3.3.2. Kërkesat e raportimit të të dhënave dhe auditimit.....	19
4.0. Burimet e të dhënave.....	20
4.1. Të dhënat për fermat	20
4.1.1. Përshkrimet e prodhuesit dhe mundësitë për sigurime	20
4.1.2. Përcaktimi i detyrimit.....	21
4.1.3. Praktikat më të mira të menaxhimit	21
4.1.4. Inicimi i ankesave	21
4.2. Të dhënat e sistemit të sigurimeve bujqësore	22
4.3. Të dhënat e palës së tretë.....	22
4.3.1. Çmimet e mallrave	22
4.3.2. Çmimet e faktorëve.....	23
4.3.3. Të dhënat e indeksit të përafërt.....	23

5.0. Dosjet e të dhënave dhe informatave.....	24
5.1. Një shembull nga Shtetet e Bashkuara	24
6.0. Kontrolli i cilësisë.....	29
6.1. Brengat për menaxhimin e të dhënave	29
6.2. Transferi i të dhënave.....	30
6.3. Mungesa e të dhënave	30
6.4. Vlerat ekstreme.....	31
6.5. Trendi i të dhënave.....	31
6.6. Azhurnimi dhe rishikimi i të dhënave.....	31
7.0. Qasja dhe siguria e të dhënave.....	32
7.1. Siguria e të dhënave.....	32
7.1.1. Konfidencialiteti	32
7.1.2. Integriteti	32
7.1.3. Disponueshmëria	32
7.1.4. Autenticiteti	33
7.1.5. Jo-refuzimi.....	33
7.2. Qasja, kontrolli dhe transparenca	33
7.2.1. Identifikimi	33
7.2.2. Autentikimi	33
7.2.3. Autorizimi.....	33
8.0. Hardueri, softueri dhe kopja rezervë e të dhënave kompjuterike.....	34
8.1. Kërkesat e harduerit dhe softuerit	34
8.1.1. Performanca	34
8.1.2. Kostoja.....	34
8.1.3. Kapaciteti i ruajtjes.....	34
8.1.4. Varshmëria.....	35
8.1.5. Kopja rezervë dhe rikthimi pas fatkeqësive	35
9.0. Përmbledhje	36

Parafjala dhe falënderimet

KFN i ka përgatitur pesë doracakë për zhvillimin e tregjeve të sigurimeve bujqësore ku sektori publik dhe privat punojnë së bashku në partneritet (PPP). Doracakët janë të dizajnuar për ta zhvilluar kapacitetin e qeverisë dhe lojtarëve të tregut për të dizajnuar në mënyrë efektive produktet e sigurimeve bujqësore, si kompensimin tradicional ashtu edhe indeksin, për t'i paraqitur ato në treg dhe për zhvillimin e shitjeve. Doracakët janë dizajnuar të jenë koncizë por në të njëjtën kohë të mjaftueshëm për të krijuar bazat teknike dhe administrative për një sistem modern të agro-sigurimeve dhe për të mundësuar që programet në fazat e hershme të zhvillimit ta planifikojnë siç duhet sistemin e kërkuar. Në fund, doracakët janë dizajnuar për t'i trajnuar praktikuesit, për të ndërtuar kapacitetet lokale me aftësitë që kërkohen për ta filluar programin dhe për t'i mundësuar programit të rritet me kalimin e kohës.

Autori kryesor i doracakëve është Profesor Myles Watts, Profesor i Universitetit, Ekspert Kryesor i Sigurimeve në Watts & Associates, Anëtar i Bordit në Korporatën Federale të Hipotekave Bujqësore dhe Bujk i Gjeneratës së 5-të në Montana. Watts dhe Associates kanë dizajnuar dhe futur në përdorim produkte të shumta të agro-sigurimeve në Amerikën e Veriut, shpesh këshillohen për ri-siguruesit më të mëdhenj dhe përkrahin programet e sigurimeve në mbarë botën. Ata kanë themeluar kompaninë e tyre të sigurimeve të indeksit, eWeatherRisk. Doracakët përfshijnë mësimet praktike të mësuara gjatë 40 viteve të fundit.

Zhvillimi i doracakëve ka qenë një aktivitet i përbashkët i projektit të Agro-Sigurimeve në Ukrainë (2007-2015), Ekipit Global të Agro-Financave të KFN-së dhe Fondit Global të Sigurimeve të Indeksit (FGSI) (2009 deri më sot). Dr. Gary Reusche ka udhëhequr projektin e Ukrainës, ka shërbyer si specialist teknik në ekipin global të agro-financave dhe si anëtar i komitetit teknik të FGSI-së dhe ekipit kryesor të menaxhmentit. Zhvillimi i agro-sigurimeve është i lidhur ngushtë me financat bujqësore dhe zinxhirët e vlerës dhe ato zhvillohen së bashku në mënyrë efektive.

Doracakët vijnë si rezultat i punës së trajnimit të mbajtura nga projekti i agro-sigurimeve në Ukrainë dhe në nivel global nga ekspertët teknikë të FGSI-së. I gjithë ekipi i agro-sigurimeve në Ukrainë ka dhënë kontribute praktike në doracakë, me një falënderim të veçantë për Victoria Yakubovich për mbledhjen, organizimin dhe përgatitjen e drafteve fillestare dhe për Andrey Zaripov, anëtar i ekipit të FGSI-së për ndihmën në zhvillimin e modeleve të risigurimit dhe të rrjedhës së parave. Ekipi i projektit ka përfshirë ekspertë nga programi bujqësor provincial në Alberta (Kanada), në veçanti Richard McConnell, i cili kontribuoi me përvojën dhe ekspertizën e tij në aktivitetet e trajnimit.

Shqyrtimi nga kolegët dhe përkthimet në gjuhën spanjolle të doracakut vijnë nga konsulentët e BNRZH-së në Amerikën Qendrore dhe Jugore, veçanërisht Pablo R. Valdivia Zelaya dhe Roberto Dario Bacchini.

Ekipi i është mirënjohës Profesorit Gary Brester për kontributin e tij praktik dhe redaktimin e doracakëve dhe Olesya Zhuchenkos për koordinimin e botimit të doracakëve, për punën me dizajnuesit për ta planifikuar paraqitjen dhe shtypjen.

Më në fund, përkrahja për doracakët është siguruar nga qeveria kanadeze dhe nga Fondi Global për Sigurimet e Indeksit (FGSI), kryesuar nga Gilles Jacques Galludec (Menaxher i Programit) dhe financuar nga Bashkimi Evropian, Japonia dhe Holanda.

Shkurtesat

KNF – Korporata ndërkombëtare

financiare GIIF – Indeksi global i
sigurimeve

INMRRB – Instituti ndërkombëtar për menaxhimin e rrezikut në
bujqësi DÇJTZH – Çështjet e jashtme, tregtia dhe zhvillimi, Kanadë

APX – Shkëmbimi i energjisë elektrike në Amsterdam

GHCND - Rrjeti global i klimës historike

GSOD Ditore – Përmbledhja globale botërore

TI – Teknologjia informative

NYSE – Bursa e këmbimeve në Nju Jork

SAFEX – Bursa Jugafrikane e këmbimit të kontratave të ardhme

WMO – Organizata botërore
meteorologjike

1.0. Hyrje

Menaxhimi i të dhënave dhe informacionit nënkupton zhvillimin, mbledhjen, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe metodat e nevojshme për t'i marrë, kontrolluar, mbrojtur, dorëzuar dhe rritur vlerën e tyre për të arritur qëllimet e programeve të sigurimeve bujqësore. Çështjet që lidhen me mbledhjen, zhvillimin, azhurnimin dhe cilësinë e të dhënave shpesh anashkalohen kur zhvillohen programet e sigurimeve bujqësore. Megjithatë, programet e tilla ka gjasa të dështojnë pa një plan të përpiktë dhe të zhvilluar mirë për menaxhimin e të dhënave dhe informacionit.

Të dhënat u nevojiten atyre që zhvillojnë, operojnë dhe menaxhojnë programet e sigurimeve bujqësore. Përveç kësaj, prodhuesit bujqësorë kanë nevojë për qasje në të dhëna të kualitetit të lartë për marrjen e vendimeve të tyre individuale të blerjes. Cilësia më e mirë e të dhënave dhe sasi më të mëdha të të dhënave përmirësojnë vendimmarrjen, menaxhimin dhe zhvillimin e produkteve. Programet e suksesshme të sigurimit bujqësor kërkojnë mbledhje të saktë dhe të plotë të të dhënave, menaxhim dhe siguri të tyre.

Ky doracak paraqet një gamë të gjerë çështjesh të menaxhimit që lidhen me të dhënat e sigurimeve bujqësore. Veçanërisht, diskutohen çështjet që lidhen me përdorimin e të dhënave, nevojat, dokumentacionin, kontrollin e cilësisë, sigurinë, qasjen, ruajtjen dhe politikat publike. Përveç kësaj, janë paraqitur edhe nevojat për të dhëna lidhur me nënshkrimin, korrigjimet e humbjeve, vlerësimin e primeve dhe risigurimin. Për shkak se produktet specifike të sigurimeve bujqësore shpesh kanë kërkesa të ndryshme për të dhëna, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet produkteve të tilla janë përshkruar. Në fund, në këtë doracak gjithashtu shqyrtohen çështjet dhe kërkesat e dizajnit kompjuterik të softuerit dhe harduerit dhe jep shembuj të të dhënave të nevojshme.



2.0. Përdorimi i të dhënave.

Të dhënat e sakta dhe gjithëpërfshirëse u nevojiten atyre që zhvillojnë, operojnë, menaxhojnë dhe rregullojnë programet e sigurimit të kulturave bujqësore. Në përgjithësi, metoda e preferuar për vlerësim është përdorimi i të dhënave historike për rreziqet në fjalë. Nëse të dhënat historike nuk janë në dispozicion, përdoren metoda të tjera për të vlerësuar produktet e ndryshme të sigurimit të kulturave bujqësore. Megjithatë, rezultatet e vlerësimit të tillë janë zakonisht më inferiore se ato që rrjedhin duke përdorur të dhëna të plota. Prodhuesit bujqësorë dhe organizatat prodhuese kanë nevojë për të dhëna për të vendosur nëse do të blejnë produkte ose për të zhvilluar produkte të sigurimit të kulturave bujqësore. Përveç kësaj, prodhuesit përdorin të dhëna për marrjen e vendimeve në lidhje me nivelet e mbulimit dhe blerjet e produkteve. Në shumicën e rasteve, performanca e produkteve të sigurimeve dhe efikasiteti i tyre në lidhje me menaxhimin e rrezikut për prodhuesit bujqësorë është kryesisht funksion i disponueshmërisë dhe mirëmbajtjes së të dhënave.

Ofruesit e sigurimeve primare kanë nevojë për të dhëna për të përcaktuar normat e primit, produktet e shërbimeve, për vlerësimin e performancës së produktit, monitorimin e aktivitetit prodhues individual, hulumtimin dhe zhvillimin e produkteve të reja dhe modifikimin e produkteve ekzistuese. Për më tepër, ofruesit e sigurimeve kërkojnë të dhëna për të zhvilluar rishikime financiare dhe informacione të tjera të nevojshme për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm, raportet për organizatat e jashtme dhe për vlerësimin e primeve të risigurimit. Në shumë raste, ofruesit e sigurimeve primare marrin edhe subvencione të primeve nga agjencitë qeveritare. Kështu, nevojiten të dhënat për t'i kryer ato transaksione dhe gjithashtu për procedurat e zgjidhjes së kontesteve.

Kompanitë e risigurimit kërkojnë të dhëna të plota edhe për të vlerësuar rrezikshmërinë e portfoliove të sigurimeve bujqësore, për të vendosur norma të primit të risigurimit dhe për realizimin e kontratave të risigurimit. Përveç kësaj, agjencitë qeveritare kërkojnë të dhëna për të ndihmuar në menaxhimin, operimin dhe vlerësimin e programeve të sigurimit të kulturave bujqësore. Kjo është e vërtetë pavarësisht nëse produktet ofrohen përmes sektorit privat ose direkt nga agjencitë qeveritare. Në të gjitha rastet, agjencitë qeveritare ka gjasa të përfshihen në rregullimin dhe monitorimin e programeve të sigurimit të kulturave bujqësore - veçanërisht kur ato japin subvencione të primeve ose subvencione administrative dhe/ose mbulime të ndalimit të humbjes. Agjencitë qeveritare gjithashtu janë shpesh të përfshira në veprimet rregullative, auditimet dhe procedurat e zgjidhjes së kontesteve.

2.1 Zhvillimi i programit

Zhvillimi i programeve të sigurimeve bujqësore varet shpesh nga disponueshmëria e të dhënave me cilësi të lartë. Për shembull, prodhimet individuale të rendimentit ose të ardhurave nuk mund të dizajnohen pa një sasi të mjaftueshme të të dhënave të rendimentit në nivel të prodhuesit. Në mungesë të këtyre të dhënave, programet shpesh zhvillohen rreth parimeve të rendimentit të zonës ose grupit. Përveç kësaj, produktet e të ardhurave kërkojnë që të ketë një burim të paanshëm të zbulimit të çmimeve në mënyrë që vlerësimi i produktit të ruajë arsyeshmërinë e vet aktuale.

Sasi të konsiderueshme të të dhënave duhet gjithashtu të jenë në dispozicion për zhvillimin e programeve të prekura nga korrelacionet ndërmjet prodhuesve bujqësorë individualë dhe rajoneve. Rrjedhimisht,



zhvillimi i programit shpesh është rezultat i asaj se sa ka të dhëna.

2.1.1. Planifikimi strategjik: Zhvillimi i të dhënave, qasja dhe menaxhimi janë me rëndësi kritike për suksesin e programeve të sigurimit bujqësor. Prandaj, është thelbësore që të zhvillohet një plan i menaxhimit strategjik lidhur me çështjet e të dhënave, së bashku me aspektet e tjera të programeve të sigurimeve bujqësore. Tendenca është të supozohet se çështjet e të dhënave do të zgjidhen vetë nëse së pari është zhvilluar një program solid. Megjithatë, programet solide nuk mund të zhvillohen në mungesë të planifikimit strategjik të të dhënave.

Planet strategjike të të dhënave duhet të marrin në konsideratë ndërveprimin e menaxhimit dhe marrjes së të dhënave në lidhje me politikat kombëtare të menaxhimit të rrezikut bujqësor dhe programet bujqësore. Programet e sigurimit bujqësor duhet të përkojnë me qëllimet e veprimeve të tjera të qeverisë. Nëse zhvillohen siç duhet, sisteme të tilla mund të krijojnë sinergji të konsiderueshme me politikën kombëtare në lidhje me mbledhjen, vlerësimin dhe rritjen e të dhënave.

Në fund, planet strategjike të të dhënave duhet të ndërtohen rreth objektivave të deklaruara dhe duhet të përmbushin masat e ndryshme të performancës. Në këtë mënyrë, vlerësimet e duhura të këtyre programeve mund të maten në lidhje me qëllimet e deklaruara.

2.1.2. Qeverisja e sistemit. Strukturat e qeverisjes së barabartë dhe transparente janë thelbësore për të gjitha aspektet e një programi të sigurimit bujqësor, por ato janë veçanërisht të rëndësishme për çështjet e menaxhimit të të dhënave për shkak të natyrës personale dhe konfidenciale të të dhënave dhe dokumenteve të informacionit. Çështjet e qeverisjes janë të lidhura drejtpërdrejt me disponueshmërinë dhe mbledhjen e të dhënave. Për shembull, qeverisja e të dhënave duhet të marrë në konsideratë kërkesat për raportimin e detajeve të kontratave (p.sh., personat juridikë, sipërfaqet e tokës etj.), të japë detaje për zgjidhjen e kontesteve dhe të zhvillojë praktikën më të mira të menaxhimit për informacionin, bizneset, veprimet e agronomisë dhe veprimtaritë e sigurimit.

Strukturat e qeverisjes duhet të përshkruajnë qartë rregullat dhe zbatimin e detajeve të kontratës si përshtatshmëria e produktit, kulturat bujqësore, rreziqet, dizajnin, humbjet, afatet dhe pasojat për keqinterpretimin e secilës prej tyre. Në secilin rast, strukturat e qeverisjes duhet të ofrojnë qartë arsye për pse ka nevojë për një informacion të tillë. Qeverisja e të dhënave është gjithashtu e rëndësishme për nënshkrimin e marrëveshjeve të sigurimit dhe zhvillimin e standardeve për rregullimin e humbjeve.

Vendimet e qeverisjes duhet të përfshijnë edhe proceset për ofrimin e informatave të mjaftueshme për vendim-marrje optimale për të gjithë aktorët. Për shembull, nevojat për të dhëna të agjencive rregullative përfshijnë informacion mbi kompanitë e sigurimit të kulturave bujqësore. Nevoja për këto të dhëna dhe informacione mund të jetë mjaft e ndryshme nga ato të palëve të brendshme

dhe personelit të sistemit. Palët e jashtme dhe krijuesit e politikave kanë nevoja të ndryshme për të dhëna, si edhe kompanitë e risigurimit.



2.1.3. Koordinimi i funksioneve të biznesit: Të dhënat e sakta dhe aktuale janë të nevojshme për të menaxhuar dhe koordinuar në mënyrë efektive funksionet e sigurimeve bujqësore. Këto funksione janë produkt i nevojës për të komunikuar me pjesëmarrësit dhe për të zhvilluar shqyrtime transparente të proceseve të biznesit.

Drejtimet dhe arsyetimet strategjike, anëtarët e ekipit dhe vlerësimet e performancës janë shembuj të komunikimit të brendshëm që kërkojnë përdorimin e procesit të biznesit dhe të dhënave dhe informacionit të qeverisjes. Përpjekjet për komunikim të jashtëm përfshijnë përgjigjet e shpejta ndaj kërkesave për informata dhe materialet arsimore që janë në dispozicion për shpërndarje. Materialet e tilla duhet të mbahen aktuale dhe duhet të krijohen sistemet për ta monitoruar kontrollin e versioneve të të gjitha dokumenteve të jashtme.

Komunikimet efektive me klientët (prodhuesit), përfaqësuesit e mediave dhe zyrtarët qeveritarë kërkojnë që të zhvillohen sistemet e përcjelljes për t'iu përgjigjur kërkesave. Sistemet efikase të përcjelljes sigurojnë që të gjitha kërkesat të marrin përgjigje brenda një afati të arsyeshëm kohor. Përveç kësaj, sistemet e tilla duhet të monitorojnë përgjigjet kthyesë për ta përmirësuar cilësinë.

Proceset e tjera të biznesit që kërkojnë të dhëna dhe dokumentacion përfshijnë monitorimin e performancës së çdo aspekti të sistemit të sigurimeve bujqësore. Për shembull, aktivitetet e korrigjimit të humbjeve duhet të monitorohen në lidhje me përgjigjet ndaj kërkesave, veprimet nga korrigjuesit e humbjeve dhe dhënien e kompensimit. Sistemet e shqyrtimit të proceseve të biznesit gjithashtu kërkojnë të dhëna të konsiderueshme për monitorimin e aktivitetit të zakonshëm të biznesit siç janë llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme. Përveç kësaj, mund të ofrohen zbritje për pagesën e parakohshme të të arkëtueshmeve; këto detaje duhet të monitorohen me kujdes.

2.1.4. Raportimi financiar dhe llogaridhënia: Sistemet e sigurimit bujqësor kërkojnë shuma të konsiderueshme të të dhënave të menaxhimit të biznesit për qëllime të raportimit financiar dhe llogaridhënies. Këto raporte u dërgohen në mënyrë rutinore agjencive qeveritare, rregullatorëve, menaxherëve dhe investitorëve.

Agjencitë rregullative shpesh kërkojnë raportimin e masave të performancës në lidhje me qëllimet, rrezikun e portfolios, raportet e humbjeve dhe informacionin në lidhje me qëndrueshmërinë financiare. Kornizat rregullative duhet të zhvillohen në bashkëpunim me sistemet e menaxhimit të të dhënave për të zvogëluar kostot e raportimit.

Raportet financiare të brendshme shpesh janë të nevojshme për ta vlerësuar rrezikun e portfolios, nevojat për para të gatshme për të përmbushur kërkesat e kompensimeve, kostot administrative dhe shpenzimet fikse. Përveç kësaj, agjencitë qeveritare shpesh kërkojnë raporte specifike për aktivitete të ndryshme të sigurimit. Pjesa më e madhe e të dhënave të nevojshme për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave janë në dosjet e gjeneruara nga ofruesit e sigurimeve në lidhje me shitjen e produkteve të sigurimit. Është thelbësore që sistemet e menaxhimit të biznesit të jenë në gjendje t'i marrin këto të dhëna pa pengesa për të ulur kostot dhe për të rritur kohën e reagimit.

Të dhënat janë gjithashtu të nevojshme për ndërveprimin efektiv ndërmjet kompanive private që ofrojnë sigurime, agjencive qeveritare që monitorojnë dhe mund edhe të ofrojnë sigurime dhe agrobizneseve. Prodhuesit bujqësorë duhet të pajisen me të dhëna kuptimplota dhe të kuptueshme në lidhje me performancën e produkteve.

Të dhënat e sakta dhe të besueshme shpesh ndihmojnë për të shmangur objektivat konkurruese ndërmjet pjesëmarrësve të sigurimeve bujqësore. Prodhuesit preferojnë norma të ulëta të primit, nivele të larta mbulimi dhe kushte fleksibile për korrigjimin e humbjeve. Siguruesit dhe risiguruesit duan të kompensohen për rrezikun e shkaktuar nga ofrimi i programeve të tilla. Administratorët e programeve shpesh kërkojnë fleksibilitetin e menaxhimit, mbikëqyrjen dhe buxhetet e mjaftueshme për të kryer rolet e tyre. Shumë nga objektivat konkurruese mund të përmbushen nëse të dhënat përdoren për të ilustruar problemet e palëve të interesuara.

2.2. Dizajni i produktit

Fushat kryesore të dizajnit të produktit për të cilat janë më të rëndësishme kërkesat për të dhëna përfshijnë nënshkrimin e marrëveshjes, vlerësimin dhe kompensimin. Sasi të mëdha të të dhënave të kualitetit të lartë janë të nevojshme kur përdoren metoda empirike për të zhvilluar norma të primeve me arsyeshmëri aktuariale dhe për përcaktimin e politikave të kompensimit.

Dizajnimi i produktit duhet të bëhet i lidhur me zhvillimin e sistemeve të mbledhjes dhe menaxhimit të të

dhënave. Produktet nuk mund të realizohen siç duhet nëse injorohen çështjet e lidhura me cilësinë e të dhënave, sasinë, saktësinë dhe afatet kohore të nevojshme për të përmbushur kërkesat operacionale të programit.

2.2.1. Kërkesat për të dhëna në vlerësimin empirik: Nevoja për sasi të mëdha të të dhënave historike me cilësi të lartë është më urgjente për vendosjen e normave të primit. Proceset empirike të vlerësimit ofrojnë metodën më të arsyeshme aktuariale ndaj vlerësimit dhe kanë si rezultat norma më të ulëta të primit në krahasim me metodat e tjera. Megjithatë, proceset empirike të vlerësimit kërkojnë shumë të dhëna. Për shembull, një grup ideal i të dhënave për vlerësimin e një produkti individual të sigurimit të rendimentit do të përbëhej nga më shumë se 100 vjet vëzhgime për çdo prodhues në çdo rajon të caktuar. Të dhënat e tilla rrallë janë në dispozicion, kështu që shpesh përdoren edhe procedura të tjera. Për shembull, periudha më të shkurtra të të dhënave zakonisht

përdoren për proceset e vlerësimit empirik. Nivelet e primeve pastaj rriten për faktorë të ndryshëm të ngarkesës për të reflektuar rreziqet e panjohura që nuk mund të përcaktohen për shkak se të dhënat janë të pamjaftueshme.

2.2.1.1. Kombinimi i të dhënave duke përdorur procedurat bootstrapping

Në disa raste, të dhënat e rendimentit rajonal mund të jenë në dispozicion për një periudhë relativisht të gjatë kohore, ndërsa të dhënat e nivelit individual të fermave shpesh nuk janë. Në këto raste, procedurat bootstrapping mund të përdoren për të kombinuar të dhënat afatshkurtra të nivelit të fermës me të dhënat afatgjata rajonale. Procedurat bootstrapping kombinojnë variacionet afatgjata rajonale të rendimentit me variacionet në observimet e rendimentit të shumë fermave për ta rritur saktësinë e vlerësimeve të variancës së rendimenteve të fermave individuale. Këto variacione të korigjuara përdoren pastaj për vendosjen e normave të primit.

2.2.2. Kërkesat për të dhëna për vlerësimin parametrik:

Procedurat e vlerësimit parametrik përdoren shpesh kur të dhënat historike janë të pamjaftueshme për të dhënë prime të arsyeshme empirike. Të dhënat historike thjesht mund të mos ekzistojnë në sasinë e nevojshme, ose mund të jenë me cilësi të dobët. Të dhënat e cilësisë më të dobët paraqiten kur observimet kanë pasaktësi ose u mungojnë vlera, mblidhen duke përdorur metoda jokonsistente ose janë të ndikuara nga ndryshimet e politikave. Në këto raste, shumë distribucione statistikore mund të përdoren për të përfaqësuar variacionin në rendimentet që paraqiten në observimet aktuale. Në disa raste, të dhënat e kufizuara historike mund të ndihmojnë në identifikimin e distribucionit të duhur statistikor për qëllime të vlerësimit. Në raste të tjera, mund të supozohet thjesht distribucioni normal ose uniform. Këto dy distribucione shpesh japin pikat përfundimtare konservative dhe liberale për seritë e normave të primit. Distribucionet statistikore përdoren për të vendosur kompensimet e pritura të cilat më pas kombinohen me detyrimet për të përcaktuar norma të rrezikut të pastër. Këto procedura, megjithatë, shpesh kërkojnë shtimin e shumë faktorëve të ngarkesës së normës së primit për ta reflektuar pasigurinë e lidhur me rezultatet e rendimentit aktual.

2.3. Menaxhimi i programit

Të dhënat e besueshme që menaxherët e programeve mund t'i marrin lehtë janë thelbësore për suksesin e programeve të sigurimeve bujqësore. Administratorët dhe menaxherët e programit përdorin të dhënat për:

- Zhvillimin e planeve strategjike;
- Ndërveprimin me agjencitë qeveritare dhe kompanitë private të sigurimit;
- Vlerësimin e rezultateve të vlerësimit;
- Zhvillimin dhe përshtatjen e produkteve;
- Kryerjen e auditimeve të brendshme;
- Përgatitjen e raporteve financiare;
- Vlerësimin e proceseve të biznesit në aspektin e efikasitetit dhe efektivitetit.

Komunikimi efektiv ndërmjet kompanive të sigurimeve private, risiguruesve, agjencive qeveritare, rregullatorëve dhe prodhuesve bujqësorë është thelbësor për kontrollin e këtyre programeve. Përveç kësaj, të dhënat përdoren edhe në aktivitetet e përditshme:

- Për përkrahjen dhe regjistrimin e shitjeve;
- Në procesin e aplikimit për produkte;



- Për procesin e nënshkrimit të marrëveshjes;
- Për qëllime korrigjimi të humbjeve;
- Për përkrahjen e procedurave të procesimit të kërkesave;
- Për proceset e zgjidhjes së kontesteve.

2.4. Vlerësimi i programit

Programet e sigurimeve bujqësore në përgjithësi kanë një komponent të sektorit publik të lidhur me to. Prandaj, vlerësimi i programit është i nevojshëm për të vendosur nëse objektivat publike janë duke u përmbushur. Përveç kësaj, vlerësimi i brendshëm i programeve është një pjesë thelbësore e procedurave të përgjithshme të biznesit. Në të dy rastet, të dhënat janë të nevojshme për hulumtim dhe për ta vlerësuar efikasitetin e programeve të sigurimeve bujqësore. Përveç kësaj, krijuesit e politikave shpesh kanë nevojë për informacion lidhur me pasojat e programeve të sigurimit të kulturave bujqësore në prodhimin bujqësor, çështjet mjedisore, organizimin industrial të agrobiznesit, furnizimet e ushqimit dhe qëllimet e politikës publike. Kompanitë e sigurimeve përdorin të dhënat e performancës për të identifikuar fushat për përmirësimin e produkteve, për të zhvilluar produkte të reja dhe për të korrigjuar qëllimet e programit.

2.5. Dokumentimi

Të dhënat duhet të regjistrohen dhe mirëmbahen me saktësi. Një sistem i mirë i menaxhimit të të dhënave jo vetëm që regjistron të dhëna, por edhe dokumenton burimet e të gjitha observimeve. Dokumentimi i të dhënave dhe burimeve të tyre mundëson vazhdimësi pa pengesa të programeve kur ato zhvillohen, rriten dhe ndryshohen. Përveç kësaj, shumëllojshmëria e dokumenteve dhe burimeve të tyre duhet të mbahet nga programet e menaxhimit të të dhënave të sigurimeve bujqësore.

2.6. Politika publike

Resurset publike përdoren shpesh për të përkrahur programet e sigurimeve bujqësore. Arsyetimi për përfshirjen e sektorit publik shpesh përqendrohet në ruajtjen e komuniteteve rurale, zvogëlimin e nevojës për ndihmë në raste fatkeqësish, stabilizimin e furnizimeve ushqimore dhe përkrahjen e të ardhurave të fermës nëpërmjet zvogëlimit të rreziqeve. Kështu, nevojiten burime të konsiderueshme të të dhënave për të zhvilluar dhe vlerësuar çështjet e politikave publike që lidhen me programet e sigurimeve bujqësore.

Të dhënat nevojiten për ta vlerësuar se a janë duke u realizuar qëllimet e politikave publike. Llogaridhënia publike e programeve të tilla kërkon që kompanitë të kalojnë nëpër auditime të pavarura nga palët e treta për produktet dhe performancën e menaxhimit të biznesit. Prodhuesit, taksapaguesit, rregullatorët dhe zyrtarët qeveritarë duhet të sigurohen që burimet publike janë duke u përdorur në mënyrë efektive.

Llogaridhënia e politikave publike mund të vazhdojë përtej një shteti të vetëm. Për shembull, programet e sigurimeve bujqësore duhet të vlerësohen për pajtueshmërinë me marrëveshjet tregtare ndërkombëtare, veçanërisht për programet që marrin subvencione të konsiderueshme qeveritare.

Kompanitë e sigurimeve duhet gjithashtu të mbajnë të dhëna të mjaftueshme për të demonstruar pajtueshmërinë rregullative me agjencitë e ndryshme publike. Për më tepër, këto kompani duhet të respektojnë rregullat ligjore që rregullojnë çështjet e pajtueshmërisë kontraktuale. Pra, pronësia, qasja, konfidencialiteti dhe përdorimi i të dhënave duhet të respektojnë udhëzimet ligjore.



3.0. Nevojat për të dhëna

Zhvillimi, realizimi dhe mbikëqyrja e metodave për të marrë, kontrolluar, mbrojtur, ofruar dhe rritur vlerën e të dhënave dhe asetëve të informacionit janë elemente të rëndësishme të një programi të menaxhimit të të dhënave. Menaxhimi i të dhënave në programet e sigurimeve bujqësore përfshin më shumë se numrat dhe përfshin ruajtjen e informacionit personal të prodhuesve, dokumentet e politikave dhe praktikat e menaxhimit të biznesit.

Nevojitet shumëllojshmëri e nevojave fillestare të të dhënave për zhvillimin e programeve të sigurimeve bujqësore. Megjithëse shumica e produkteve kërkojnë të paktën disa të dhëna të përbashkëta, çdo produkt kërkon edhe informacion specifik.

Të dhënat nevojiten edhe për nevojat operacionale. Për shembull, të dhënat duhet të azhurnohen çdo vit për t'i përmirësuar proceset e vlerësimit dhe për të vlerësuar produktet dhe programet.

3.1. Nevojat fillestare për të dhëna

Produktet e sigurimeve bujqësore mund të kategorizohen në dy lloje të përgjithshme: (1) produkte individuale dhe (2) produkte të përafërta. Kjo taksonomi është një element i rëndësishëm i kërkesave për të dhëna. Pagesat e kompensimit për produktet individuale aktivizohen nga rendimenti ose të ardhurat individuale lidhur me parcelat e caktuara të tokës. Detyrimet e produkteve individuale përgjithësisht përcaktohen nga rendimenti aktual i prodhuesit ose rezultati i të ardhurave.

Nga ana tjetër, produktet e përafërta aktivizohen nga variablat që lidhen me rezultatet aktuale individuale. Shembujt e variablave të përafërta përfshijnë rendimentin/të ardhurat për njësi të sipërfaqes, çmimet kombëtare, rezultatet e motit dhe imazhet satelitore. Detyrimet e produkteve të përafërta zakonisht përcaktohen nga rezultatet historike rajonale. Përndryshe, detyrimi i produkteve të përafërta mund të bazohet në rezultatet individuale të prodhuesit. Rrjedhimisht, kërkesat për të dhëna janë shumë të ndryshme varësisht nga lloji dhe dizajni i produktit.

Produktet individuale kërkojnë të dhëna historike të nivelit të fermës për vlerësimin dhe korrigjimin e humbjeve. Kështu, produktet individuale kërkojnë shumë të dhëna për shkak të numrit të madh të prodhuesve të fermave, kohëzgjatjes së tyre në bujqësi dhe ndryshimeve në strukturat dhe madhësinë e fermës. Kur merren të dhëna për produkte individuale, kërkesat duhet të mbahen në minimum dhe të mos jenë dyfishuese. Vazhdimësia e serive të të dhënave duhet të mbahet edhe në qoftë se një prodhues ndryshon ofruesit primarë të sigurimeve përgjatë viteve. Kërkesat për të dhëna duhet të jenë të automatizuara dhe konsistente përgjatë viteve. Saktësia dhe plotësia e të dhënave janë elemente thelbësore të produkteve të sigurimit individual.

Produktet e përafërta zakonisht nuk mbështeten në informacion për performancën specifike të një ferme individuale. Vlerësimi dhe kompensimet në këtë rast bazohen në rezultatet që ndodhin brenda një rajoni. Kjo e ul në masë të madhe sasinë e të dhënave që duhet të mblidhen nga prodhuesit dhe sasinë e monitorimit, mbledhjes së të dhënave dhe korrigjimit të humbjeve që duhet të bëhet çdo vit. Megjithatë, të dhënat që mblidhen duhet të jenë të dokumentuara mirë dhe transparente në rastin e rendimenteve të zonës dhe të produkteve të sigurimit sipas të ardhurave. Për shkak se këto produkte janë të bazuara në rendimentet ose të ardhurat rajonale dhe jo



në rezultatet e nivelit të fermës, prodhuesit ka gjasa të vënë në dyshim të dhënat kur rezultatet në aktivitetet e tyre ndryshojnë nga rezultatet rajonale. Përveç kësaj, ndërkohë që produktet e motit ose imazheve satelitore me bazë në zonë nuk kërkojnë të dhëna nga prodhuesit individualë për llogaritjet e kompensimit, ato prodhojnë sasi voluminoze të të dhënave që duhet të menaxhohen me kujdes dhe të monitorohen për të parë nëse ka ndërprerje dhe mungesa.

Produktet e sigurimit të marzhit kombinojnë disa elemente të produkteve individuale dhe të përafërta. Prandaj, nevojat për të dhëna të këtij produkti janë një hibrid i dy të tjerave.

Megjithatë, çdo produkt sigurimi kërkon disa të dhëna dhe dokumentacion të përbashkët. Për shembull, emrat e plotë ligjorë të prodhuesve, adresat postare, identifikuesit individualë, numrat e telefonit dhe adresat e e-mailit duhet të mblidhen kur një prodhues fillimisht blen një kontratë sigurimi. Pas kësaj, ofruesit duhet të jenë të njoftuar nga prodhuesit nëse ndodhin ndryshime në ata identifikues.

Të gjitha produktet kërkojnë edhe një përshkrim fizik të fermave dhe zonave që duhet të sigurohen brenda këtyre fermave. Madhësitë dhe përshkrimet ligjore të pronës janë gjithashtu të nevojshme.

Për secilën polisë sigurimi në secilën zonë të siguruar, dokumentacioni duhet të përfshijë emrin e ofruesit të sigurimit, produktin e blerë, numrin e polisës, rezultatet e pritura (p.sh., rendimentet, të ardhurat, reshjet etj.), nivelet e mbulimit dhe zbritjet dhe aktivizuesit e kompensimit. Përveç kësaj, duhet të dokumentohen çmimet e përdorura për të llogaritur kompensimet, detyrimet totale, normat e primit, primet totale, primet totale të paguara nga një prodhues, subvencionet totale të primit (nëse ka), dhe kohën e pagesave të kompensimit.

3.1.1. Nevojat për të dhëna për sigurime individuale Dy produktet kryesore të sigurimit individual janë sipas rendimentit dhe sipas të ardhurave. Sa i përket produkteve të sigurimit sipas rendimentit, kompensimet paguhen kur rendimentet aktuale për njësi të sipërfaqes nuk arrijnë një vlerë të caktuar. Për produktet sipas të ardhurave, kompensimet paguhen kur të ardhurat për njësi të sipërfaqes (d.m.th. rendimenti/sipërfaqe shumëzuar me çmimin/njësine) nuk i arrijnë vlerat e caktuara.

3.1.1.1. Të dhënat e sigurimeve të rendimenteve individuale: Për produktet individuale të sigurimit sipas rendimentit, kërkohet historia e rendimentit të kulturës bujqësore për secilin hektar të siguruar sipas sezonit të kultivimit. Të paktën katër vjet të të dhënave duhet të përfshihen, por dhjetë ose më shumë vite preferohen. Duhet të merren parasysh kulturat rrotulluese ose vitet kur nuk ka pasur të mbjella. Nëse këto të dhëna nuk janë në dispozicion, duhet të vendosen vlera alternative. Për disa kultura bujqësore, nevojiten edhe rezultatet e llojlojshmërisë dhe cilësisë. Përveç kësaj, çmimi për njësi në të cilën do të kompensohen humbjet e fitimit duhet të jetë i njohur qartë.

Kërkesat për praktikën më të mira të menaxhimit duhet të dokumentohen duke përfshirë datat e mbjelljes, potencialisht kërkesat për përdorim të plehut artificial, herbicideve dhe pesticideve, aktivitetet e ujitjes (nëse ka) dhe praktikën e tjera të nevojshme sipas nevojës.

Kërkesat për kompensim dhe korrigjimin e humbjes duhet të dokumentohen në kohë të përshtatshme. Përshkrimet e humbjeve të mbuluara dhe të pambuluara duhet të përgatiten, si dhe shumat dhe datat e pagesave të kompensimit. Përveç kësaj, rendimentet për çdo vit të kultivimit duhet të mblidhen sapo prodhuesi të lidhë një kontratë sigurimi, pavarësisht nëse është iniciuar kërkesa.

3.1.1.2. Të dhënat e sigurimeve të të ardhurave individuale: Të gjitha të dhënat e kërkuara për produktet individuale të sigurimit sipas rendimentit janë relevante edhe për produktet individuale të sigurimit sipas të ardhurave. Përveç kësaj, duhet të specifikohet dokumentimi i çmimeve që do të përdoren për llogaritjen e të ardhurave. Këto çmime mund të ndryshojnë nga ato që përdoren për të llogaritur kompensimet për rendimentet e produkteve. Kërkesat shtesë për të dhëna përfshijnë çmimet e pritura të korrjes, të ardhurat e pritura për njësi, nivelet e mbulimit të të ardhurave dhe zbritjet nga të ardhurat. Përveç kësaj, dokumentacioni duhet të tregojë qartë të ardhurat dhe detyrimet totale aktivizuese.

3.1.2. Nevojat për të dhëna për sigurime sipas vlerës së përafërt: Produktet e sigurimit sipas vlerës së përafërt janë të dizajnuara për të kompensuar prodhuesit për humbjet që nuk maten drejtpërdrejt. Ekzistojnë shumë arsye për zhvillimin e produkteve të tilla. Në disa raste, është thjesht shumë e shtrenjtë të maten disa rezultate të caktuara. Për shembull, ushqimi i kafshëve konsumohet nga kafshët dhe nuk mund të matet drejtpërdrejt. Përveç kësaj, rreziku moral i lidhur me disa mallra bujqësore dhe situata rajonale e bën përdorimin e produkteve të sigurimeve individuale të papërshtatshme ose kostot e aktiviteteve të papërbalueshme.

Në raste të tilla, produktet e sigurimit sipas vlerës së përafërt mbështeten në rezultate që është më e lehtë të maten për të llogaritur kompensimet. Këto vlera të përafërta janë përgjithësisht të lidhura me matjet rajonale dhe jo ato individuale. Për shkak se humbjet nuk maten drejtpërdrejt, matja e vlerës së përafërt e përdorur për të aktivizuar kompensimin e sigurimit nuk mund të jetë në korrelacion perfekt me përvojat individuale të humbjeve në një periudhë kohore të dhënë.

Janë zhvilluar disa matje të përafërta, duke përfshirë rendimentin në sipërfaqe, të ardhurat e zonës, sigurimin e çmimeve, motin dhe imazhet satelitore të rritjes vegjetative. Në disa raste, rendimentet e

kulturave bujqësore që maten më lehtë dhe ku rendimentet kanë korrelacion më të lartë me një kulturë tjetër bujqësore përdoren ndonjëherë si vlerë e përafërt. Kostot e produkteve të tilla kryesisht varen nga infrastruktura ekzistuese sepse lidhen me mbledhjen e matjeve të vlerave të përafërta.

Alternativat e sigurimit të vlerave të përafërta zakonisht kërkojnë që shumë më pak të dhëna të merren nga fermat individuale. Megjithatë, kërkesat dhe menaxhimi i të dhënave totale mund të jenë mjaft të mëdha si rezultat i matjeve voluminoze me kalimin e kohës. Përveç kësaj, produktet me bazë të përafërt nuk kërkojnë histori individuale të fermave ose korrigjime të humbjeve personalisht për të përmbushur kërkesat. Sidoqoftë, duhet të bëhet një monitorim për të siguruar që kulturat bujqësore që sigurohen janë duke u prodhuar.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse subvencionet qeveritare po përdoren për të kompensuar pagesat e primeve.

3.1.2.1. Të dhënat e sigurimeve të rendimenteve sipas zonës: Përveç të dhënave të nevojshme për të gjitha produktet e sigurimeve, produktet e rendimentit sipas zonës gjithashtu kërkojnë të dhëna lidhur me historinë e zonës ose rendimentin rajonal të kulturës bujqësore që sigurohet. Kjo histori duhet të jetë aq e gjerë sa është e mundur për qëllime vlerësimi. Përveç kësaj, zonat aktuale ose rendimentet rajonale duhet të llogariten në kohën e duhur pas korrjeve. Kjo mund të jetë detyrë e vështirë, sepse shumica e vlerësimeve të rendimentit rajonal varen nga vlerësimet e prodhuesve. Vonesat në marrjen e këtyre të dhënave mund ta marginalizojnë arsyen fillestare për blerjen e sigurimit (d.m.th, kompensimi me kohë i një humbjeje).

Pas sezonit të kultivimit ose korrjes, të dhënat e rendimentit të rajonit që përdoren për të llogaritur aktivizuesit e kompensimeve duhet të publikohen. Duhet të njoftohen rendimentet aktivizuese për secilin nivel të mbulimit. Siç është rasti për të gjitha kërkesat, pagesat e kompensimit dhe datat duhet të dokumentohen.

Produktet e rendimentit sipas zonës zakonisht mbështeten në mbledhjen e të dhënave të palëve të treta. Prandaj, metodat e përdorura për mbledhjen e këtyre të dhënave duhet të kuptohen mirë. Përveç kësaj, është e rëndësishme që këto të dhëna të mblidhen duke përdorur metoda konsistente me kalimin e kohës.

3.1.2.2. Të dhënat e sigurimeve të të ardhurave sipas zonës: Përveç të dhënave të kërkuara për sigurimin e rendimentit sipas zonës, sigurimi i të ardhurave sipas zonës kërkon të dhëna për zonën ose të ardhurat rajonale për njësi të siguruar. Kjo do të thotë, çmimet mesatare të mallrave për një rajon duhet të vendosen për të llogaritur të ardhurat e pritura të zonës dhe për të dhënë aktivizuesit e kompensimit. Të njëjtat probleme të të dhënave të palëve të treta që ndikojnë në mbledhjen e të dhënave të rendimentit janë gjithashtu relevante për mbledhjen e të dhënave të çmimeve të përdorura në produktet e sigurimit të të ardhurave.

3.1.2.3. Të dhënat e sigurimit të çmimeve: Sigurimi i çmimeve është në përgjithësi një produkt i lidhur me blegtorinë (p.sh., gjedhët, delet dhe derrat). Këto produkte zakonisht bazohen në numrin e kafshëve të tregtuara nga një individ. Megjithatë, çmimet e pritura dhe aktivizuesit e kompensimit bazohen në rezultatet e çmimeve në nivel kombëtar ose rajonal. Rrjedhimisht, këto produkte kanë komponentë individualë dhe gruporë ose të zonës.



Përveç të dhënave të kërkuara për të gjitha produktet e sigurimit, të dhënat shtesë të nevojshme përfshijnë:

- Numrin e bagëtive që duhet të sigurohen;
- Përshkrimin fizik të bagëtisë (p.sh., cilësia, pesha e pritur në kohën e shitjes);
- Çmimin e bagëtisë kur blihet sigurimi;
- Çmimin e pritur të bagëtisë në datën e shitjes;
- Çmimin aktual të bagëtisë në datën e shitjes;
- Nivelin e mbulimit të çmimeve/zbritjes bujku i përzgjedhjes;
- Normën e primit;
- Subvencionimin e primit (nëse ka);
- Shumën e kompensimit (nëse është relevante).

3.1.2.4. Të dhënat e produktit të indeksit të motit: Produktet e indeksit të motit mund të trajtojnë masa të vetme ose të shumëfishta. Produktet me vetëm një indeks të motit mund të kenë pagesa të kompensimit "të gjitha ose asgjë" dhe mund të bazohen në indekset e reshjeve, temperaturës (mot i nxehtë ose i ftohtë) ose transpiracionin (kombinim i reshjeve dhe nxehtësisë). Do të thotë, nëse një vlerë e matur është nën një vlerë të aktivizimit, atëherë kompensimet paguhet në tërësi. Të dhënat e kërkuara për ato produkte janë zakonisht matjet e temperaturës në kohë specifike brenda një rajoni ose në afërsi me pronën e siguruar. Stacionet e motit shpesh i japin këto të dhëna.

Produktet me indeks të njëfishtë të motit dhe aktivizim të dyfishtë mund të ofrojnë kompensime proporcionale varësisht nga rezultatet që ndodhin ndërmjet dy aktivizuesve të ndryshëm. Për shembull, një aktivizues i dyfishtë i reshjeve të larta dhe të ulëta mund të përdoret për të llogaritur një kompensim që mund të ndahet në proporcion varësisht nga afërsia e observimit me nivelet e larta ose të ulëta të aktivizuesve.

Produktet me indeks të shumëfishtë të motit mund të zhvillohen për të siguruar kundër rezultateve të temperaturës dhe të reshjeve njëkohësisht me një aktivizues ose dy aktivizues. Ato mund të jenë produkte "të gjitha ose asgjë" ose mund të ofrojnë kompensime proporcionale. Edhe një herë, të dhënat zakonisht merren nga stacionet e motit.

Këto produkte kërkojnë vëmendje të veçantë për çështjet e kohës që lidhen me matjet e motit. Do të thotë, aktivizuesit e temperaturës dhe reshjeve mund të vendosen bazuar në matjet raportuese në dispozicion brenda kontekstit të një pike të vetme në kohë, gjatë një dite të vetme, gjatë stinëve të kultivimit ose në baza vjetore.

3.1.2.5. Të dhënat e imazheve satelitore: Imazhet satelitore përdoren përgjithësisht për matjen e rritjes së vegjetacionit. Ky produkt i sigurimit sipas vlerave të përafërta bazohet në korrelacionet ndërmjet matjeve të vegjetacionit dhe rezultateve të rendimentit. Përdorimi i imazheve satelitore ka kosto të konsiderueshme dhe krijon sasi të mëdha të të dhënave që duhet të menaxhohen me kujdes. Përveç kësaj, imazhet satelitore mund të ndërpriten për periudha të gjata kohore dhe ndikohen nga mbulimi me re dhe fenomeneve të tjera atmosferike. Për më tepër, të dhënat e imazheve satelitore duhet të kalibrohen për të pasqyruar me saktësi humbjet e rendimentit të kulturave bujqësore.

3.1.3. Nevojat për të dhëna për sigurime të marzhës: Ngjashëm me sigurimin e çmimeve, sigurimi i marzhës mund të ketë elemente individuale dhe grupore në aspektin e kërkesave për të dhëna. Megjithatë, pasi që sigurimi i marzhës është dizajnuar për ta ulur rrezikun e ngushtimit të diferencave ndërmjet të ardhurave nga bagëtia dhe kostove të prodhimit të bagëtisë, nevojiten shumë të dhëna shtesë, duke përfshirë:

- Kërkesat e faktorëve mesatarë historikë;
- Çmimet e pritshme të faktorëve;
- Shpenzimet e parashikuara të faktorëve gjatë sezonit aktual të rritjes;
- Nivelin e zgjedhur/zbritjen e mbulimit të marzhës.

3.2. Nevojat për të dhëna operationale

Aspektet operationale të programeve të sigurimeve bujqësore kërkojnë të dhëna të sakta dhe me kohë për të kryer funksionet afariste dhe për të siguruar informacion për vlerësimin e efektivitetit të biznesit. Menaxhimi i programit dhe transparencja rriten shumë nga sistemet e duhura të informacionit të menaxhimit të biznesit.

3.2.1. Nevojat funksionale: Funksionet operationale të programeve të sigurimeve bujqësore përfshijnë proceset e shitjes dhe aplikimit, nënshkrimin e marrëveshjes, auditimet në terren dhe korrigjimet e humbjeve, procesimin e kërkesave dhe zgjidhja e kontesteve.

Proceset e shitjes dhe aplikimit kërkojnë një strukturë për regjistrimin e shitjeve, përgjegjësitë e kontratës, informacionin e prodhuesit, kulturat bujqësore të siguruar dhe detajet e produktit. Menaxhimi operacional kërkon që ky informacion të mund të merret lehtësisht nga menaxherët.

Aktivitetet e sigurimit janë shumë të varura nga të dhënat. Të dhënat dhe informacioni në lidhje me praktikën agronomike, detyrimet kontraktuale dhe historitë e prodhimit janë me rëndësi kritike për sigurimin e duhur. Përveç kësaj, aktivitetet e sigurimit përmbushin tarifat specifike të procesimit të të dhënave, nivelet e mbulimit dhe aktivizuesit e kompensimit. Shumë aspekte të sigurimit janë specifike sipas rajonit. Prandaj, shpesh kërkohet informacioni dhe të dhënat në të gjithë rajonin ku ofrohet mbulimi.

Auditimet në terren dhe korrigjimi i humbjeve paraqesin funksione thelbësore të aktiviteteve afariste në sistemet e sigurimeve bujqësore. Kërkesat e humbjeve duhet të regjistrohen shpejt dhe të trajtohen nga korrigjuesit e humbjeve. Auditimet në terren janë të nevojshme për të siguruar se kulturat bujqësore janë mbjellur dhe praktikën agronomike janë respektuar dhe duhet të jenë të organizuara dhe monitoruara me kujdes. Përveç kësaj, korrigjuesit e humbjeve duhet të verifikojnë humbjet dhe shkaqet e tyre. Ky proces operacional kërkon qasje në të dhëna dhe informata lidhur me kontratat specifike të sigurimit dhe përshkrimet e sakta të tokës.

Pasi të jenë verifikuar humbjet dhe shkaqet e tyre, procesimi i kërkesave bëhet aspekti më i dukshëm i sistemeve të sigurimeve bujqësore nga perspektiva e një prodhuesi. Pagesat e kompensimit duhet të jenë konsistente dhe transparente në lidhje me kontratat që janë shitur. Prodhuesit duhet të kuptojnë arsyet dhe madhësinë e pagesave të kompensimit, si dhe kohën e këtyre pagesave. Ky aspekt operacional ka gjasa të jetë elementi më i rëndësishëm për krijimin e besimit në programet e sigurimeve bujqësore.



Në fund, operacionet e biznesit të programeve të sigurimeve bujqësore duhet të sigurojnë proces të qartë dhe transparent për zgjidhjen e kontesteve. Kontestet shpesh ndodhin kur ka rregulla të paqarta të sigurimit dhe menaxhimi i të dhënave dhe informacionit është jokonsistent ose i pasaktë. Sistemet e të dhënave duhet të zhvillohen për të minimizuar mospërputhjet dhe gabimet e krijuara gjatë procesit të shitjes dhe korrëgjimit të humbjeve. Auditimet e rastësishme në terren duhet të përfshihen si praktikë standarde e menaxhimit. Prodhuesit duhet të kenë udhëzime të qarta dhe koncize për apelimin e vendimeve dhe rregullat e sigurimit duhet të identifikojnë qartë një proces formal të rishikimit. Rezultatet e vendimit duhet të komunikohen shpejt dhe në tërësi ndërmjet të dyja palëve në një kontest.

3.2.2. Nevojat informative: Një shumëllojshmëri informacioni duhet të mblihdet dhe të menaxhohet për kontrollin efektiv operacional të programeve të sigurimeve bujqësore. Nevojat për informacion përfshijnë identifikimin e praktikave më të mira të menaxhimit në lidhje me aktivitetet e ndryshme agronomike, detyrimet ligjore kontraktuale, dhe procedurat e sigurimit. Informatat personale në lidhje me identifikimin e prodhuesve bujqësorë dhe parcelave të tokës janë informata kritike. Aftësia për të lidhur ose kombinuar grupet e të dhënave pa pengesa është një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të të dhënave.

Përveç kësaj, ruajtja, kopja rezervë dhe lëvizja e informacionit duhet të jenë pjesë e proceseve të planifikimit operativ. Formularët dhe aplikacionet mund të ruhen në formate në letër ose elektronike (ose të dyja). Identifikimi i prodhuesit duhet të përcaktohet qartë dhe ligjshmëria e nënshkrimeve dhe kërkesave pronësore duhet të verifikohet.

3.3. Kërkesat për të dhëna të risigurimeve

Risigurimi është procesi i transferimit të rrezikut të një subjekt tjetër. Shumica e programeve të sigurimeve bujqësore duhet të kenë të paktën një pjesë të librit të tyre të biznesit të risiguar nga kompani të tjera, sepse shumica e lëshuesve privatë të sigurimeve bujqësore nuk kanë resurse financiare për të pranuar rrezikun e detyrimeve të sigurimit të kulturave bujqësore. Përveç kësaj, produktet e sigurimeve bujqësore nuk përfaqësojnë mundësi të mjaftueshme të diversifikimit për ta zvogëluar ekspozimin ndaj rrezikut. Ndodhitë e lidhura me motin shpesh ndikojnë në rajone të gjera dhe zakonisht nuk specifikohen për kulturat e caktuara bujqësore. Për këtë arsye, kompensimet shpesh kanë korrelacion të lartë ndërmjet rajoneve.

Llojet e tjera të sigurimit (p.sh., nga lëndimi, jeta, shëndeti) kanë rreziqe që nuk kanë korrelacion të lartë me sigurimin bujqësor. Kompanitë e risigurimit krijojnë portfoliot e rrezikut që kanë korrelacione të ulëta ndërmjet rezultateve negative në të gjitha produktet, rajonet dhe periudhat kohore. Kështu, kompanitë me portfolio të tilla shpesh mund të shtojnë rreziqet e sigurimeve bujqësore pa rritur në masë të madhe ekspozimin e përgjithshëm të rrezikut.

Ofruesit e sigurimeve bujqësore shpesh kanë nevojë të bëjnë kërkesa të risigurimit për ta ceduar rrezikun në kompani më të diversifikuara dhe më të mëdha. Të dhënat janë të nevojshme për ta përcaktuar sasinë e rrezikut dhe cilësinë e programit në mënyrë që risiguresit të jenë të gatshëm ta pranojnë këtë rrezik. Cilësia e të dhënave dhe kontrolli i programit mund të kenë si rezultat pranim më të shpejtë dhe kosto më të ulët për cedimin e rrezikut.



3.3.1. Dorëzimi i risigurimeve

Proceset e dorëzimit të risigurimeve janë shumë konfidenciale dhe specifike për secilin risigurues. Qëllimi i një risiguruesi është që të mbajnë kostot e përvetësimit të rrezikut të ulëta, duke kërkuar tarifa që i kompensojnë kosto dhe rrezikun e pranuar shtesë.

Në përgjithësi, kërkesat e risigurimit përmbajnë përshkrimet e secilit produkt së bashku me çështjet konkurruese, dobinë dhe qëndrueshmërinë. Zakonisht jepen edhe detajet për madhësinë e tregut, nevojat, përdorimin dhe dizajnin e secilit produkt.

Sa i përket nevojave për të dhëna, pjesa më e madhe e kërkesave të risigurimit duhet të paraqesin dokumentacionin aktuarial, administrimin e produktit, nënshkrimin e marrëveshjes dhe informacionin për korrigjimin e humbjeve. Secili nga këta faktorë është i lidhur ngushtë me mbledhjen dhe sigurinë e saktë dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave.

3.3.1.1 Dokumentacioni aktuarial: Ky komponent i kërkesës së risigurimit përbëhet nga përshkrimet dhe dokumentacionin e të dhënave, metodat e vlerësimit, supozimet dhe shpesh një shembull vlerësimi. Një komponent i rëndësishëm i kësaj pjese përfshin një diskutim të të dhënave të përdorura për vlerësim, duke përfshirë përshkrimin e metodave të përdorura për vendosjen e normave të primit.

Dokumentacioni aktuarial shpesh ka edhe një diskutim të rreziqeve që lidhen me normat dhe primet. Prapë, ky është produkt i të dhënave historike. Të dhënat historike përdoren përgjithësisht për ta simuluar një libër biznesi të bazuar në historitë e humbjeve aktuale ose të simuluar. Efikasiteti i kësaj pjese të veçantë rritet shumë nga përshkrimet dhe dokumentacioni i saktë i të dhënave.

3.3.1.2. Administrimi i produktit. Edhe administrimi i produkteve kërkon shumë të dhëna. Jo vetëm që kjo pjesë e kërkesës së risigurimit përfshin çështje që lidhen me menaxhimin e të dhënave, por edhe me mbajtjen e regjistrave, mbajtjen e konfidencialitetit dhe sistemet e kontabilitetit. Koha e shitjeve, procesimit dhe pagesave të kompensimit gjithashtu do të përfshihej në këtë pjesë. Shqyrtimet e performancës së personelit që e monitorojnë dhe menaxhojnë këtë produkt përfshijnë edhe dokumentacionin e duhur dhe menaxhimin e të dhënave.

Dokumentet financiare - duke përfshirë pasqyrat e të ardhurave, bilancet dhe pasqyrat e parasë së gatshme të siguruesit primar - do të përfshihen në këtë pjesë dhe gjithashtu kërkojnë menaxhim të saktë të të dhënave. Në një masë të madhe, kompetenca e kompanive të përfshira në shitjet e sigurimeve bujqësore pasqyrohet në saktësinë dhe plotësinë e administrimit të produktit.

3.3.1.3. Nënshkrimi i marrëveshjes: Kërkesa e risigurimit përfshin një pjesë që përshkruan proceset e nënshkrimit të marrëveshjes. Në mënyrë specifike, dispozitat e polisave të secilit produkt do të përcaktohen në këtë pjesë. Dispozitat e tilla përfshijnë çështjet që lidhen me praktikën më të mira të menaxhimit të kërkuara nga ata që blejnë produkte të sigurimit, orarin e afateve, duke përfshirë datat e nënshkrimit të marrëveshjes dhe të primeve dhe ndodhi të tjera të rëndësishme siç janë rregullat për datat e hershme dhe të vonuara të mbjelljes dhe periudhat e korrjes. Çështjet ligjore ose të polisave që aktualisht ekzistojnë në lidhje me produktet duhet gjithashtu të dokumentohen në këtë pjesë.

3.3.1.4. Korrigjimi i humbjes: Qëllimi i korrigjimit të humbjeve është vlerësimi i kërkesave (d.m.th. monitorimi, menaxhimi i fushave, mbledhja dhe verifikimi i të dhënave, përfshirja në procesin e nënshkrimit të marrëveshjes dhe edukimi i prodhuesve). Procedurat dhe personeli i përdorur për korrigjimin e humbjeve janë komponentë të rëndësishëm për kërkesën e risigurimit. Për shembull, korrigjuesit e humbjeve mund t'i japin njësitë qeveritare ose kompanitë e sigurimeve. Përndryshe, korrigjuesit e humbjeve mund të jenë kontraktues të pavarur të certifikuar. Procedurat e korrigjimit të humbjeve dhe dokumentacioni duhet të jenë të identifikuar qartë. Duhet të specifikohet edukimi i vazhdueshëm i korrigjuesve të humbjeve. Përveç kësaj, çështjet e pajtueshmërisë me programet e tjera të qeverisë mund të jenë një komponent i proceseve të korrigjimit të humbjeve dhe procedurave për vërtetimin e vendimeve për korrigjimin e humbjeve dhe duhet të identifikohen qartë.

3.3.2. Kërkesat e raportimit të të dhënave dhe auditimit

Marrëveshjet e risigurimit specifikojnë kërkesat e ndryshme të raportimit dhe auditimit të të dhënave. Këto kërkesa sigurojnë pagesën e saktë të primeve të risigurimit dhe detyrimeve të kompensimit të risigurimit. Në shumë raste, detyrimi bruto i risiguruesit mund të kufizohet me marrëveshjet e risigurimit.

Marrëveshjet e risigurimit i përcaktojnë edhe afatet e raportimit të detyrimit dhe kompensimit. Për shembull, zakonisht specifikohet detyrimi total i pritshëm para lidhjes së risigurimit. Përveç kësaj, detyrimet totale të bëra si rezultat i shitjeve të produktit duhet të raportohen menjëherë pas datave të mbylljes së shitjeve. Nëse është koha të bëhen pagesat paraprake të kompensimit, duhet të bëhen edhe parashikimet për përfundimin e pagesave të kompensimit. Raportet e rregullat të kulturave bujqësore dhe gjendjes së rritjes së tyre dhe parashikimet e kompensimeve duhet të bëhen gjatë gjithë sezonit të kultivimit; Raporti përfundimtar duhet të merret menjëherë pas korrjes dhe para njoftimit të pagesës së risigurimit.

Duhet të zhvillohen sisteme të të dhënave dhe të biznesit që mundësojnë që risiguruesit të auditojnë transaksionet, t'i verifikojnë detyrimet dhe të bëjnë pagesat e kompensimit. Në shumicën e rasteve, risiguruesit preferojnë mundësinë për t'i monitoruar këto llogari online dhe në kohë reale. Megjithatë, këto kërkesa dallojnë sipas risiguruesit dhe sipas rregullatorëve të qeverisë.

4.0. Burimet e të dhënave

Të dhënat që përdoren në dizajnin, operimin dhe mirëmbajtjen e programeve të sigurimeve bujqësore merren nga tri burime: (1) fermat individuale, (2) sistemet e sigurimit bujqësor, dhe (3) palët e treta. Secila prej këtyre burimeve jep vlerë dhe komplikime unike.

Saktësia, konfidencialiteti dhe konsistenca janë komponentë kritike për mbledhjen e të dhënave. Të dhënat duhet të vlerësohen me kujdes dhe të kontrollohen me observimet përkatëse për ta siguruar saktësinë. Duhet të sigurohet konfidencialiteti i të dhënave të nivelit të fermës. Përveç kësaj, ata që varen nga këto të dhëna për vlerësim dhe nënshkrim të sigurimit duhet t'i kuptojnë metodat e mbledhjes së të dhënave dhe aktivitetet e burimeve të palëve të treta.

Një element tjetër kritik është transparenca. Megjithëse duhet të ruhet konfidencialiteti për prodhuesit individualë, të dhënat përmbledhëse duhet të raportohen që pjesëmarrësit dhe palët e tjera të interesit të kenë besim në vendimet e sigurimit janë të bazuara në rezultatet e të dhënave. Për më tepër, sistemet e menaxhimit të të dhënave duhet të jenë në gjendje t'i dokumentojnë ndryshimet në pronësinë e fermave, praktikat e prodhimit, prodhuesit e rinj dhe përdorimin e tokës.

Integriteti i programit është gjithashtu i rëndësishëm. Saktësia dhe konsistenca e grumbullimit të të dhënave është me rëndësi për integritetin dhe qëndrueshmërinë e programeve të sigurimeve bujqësore. Të dy faktorët ndikojnë në besimin që palët e interesuara e kanë në programe të tilla. Të dhënat duhet të mblidhen dhe të raportohen në kohën e duhur. Saktësia e të dhënave duhet të vlerësohet me kujdes, dhe korrigjimet e të dhënave ose ndryshimet procedurale duhet të jenë transparente dhe të besueshme. Rishikimi i të dhënave duhet të shqyrtohet gjithmonë brenda kontekstit të ndikimit të tyre në pagesat e kompensimit dhe në vlerësim. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për produktet e sigurimit të rendimentit të sipërfaqes dhe të ardhurave për të cilat ndodhin shpesh rishikimet e të dhënave. Qëllimi për këto rishikime duhet të jetë i qartë dhe duhet të vlerësohet ndikimi e tyre në kompensimet e propozuara ose aktuale.

Në fund, formati i ruajtjes (pra në letër ose elektronike) së bashku me kohëzgjatjen e ruajtjes së informacionit duhet të shqyrtohen me kujdes gjatë krijimit të programeve të sigurimeve bujqësore.

4.1. Të dhënat për fermat

Të dhënat e nivelit të fermës japin informacion të rëndësishëm për programet e sigurimit të kulturave bujqësore, por edhe kanë vështirësi lidhur me saktësinë, vazhdimësinë dhe periudhat e shkurtra kohore. Të dhënat e nivelit të fermës nevojiten për zhvillimin e produkteve individuale të sigurimeve dhe për qëllime vlerësimi. Këto të dhëna janë të nevojshme edhe për azhurnimin dhe vlerësimin e arsyeshmërisë aktuale me kalimin e kohës. Të dhënat e nevojshme në nivel të fermës përfshijnë identifikimin e prodhuesit dhe mundësitë e produktit, përcaktimin e detyrimit, praktikat e menaxhimit, prodhimin vjetor dhe iniciimin e kërkesave.

4.1.1. Përshkrimet e prodhuesit dhe mundësitë për sigurime: Duhet të merret informacioni në lidhje me emrin e prodhuesit ose subjektit, numrin e identifikimit, adresën e korrespondencës dhe moshën. Mund të jetë i nevojshëm dokumentacioni për ta vendosur pajtueshmërinë me rregulloret mjedisore dhe pjesëmarrjen në programet



e tjera bujqësore të qeverisë. Sipërfaqet totalentë çdo kulture bujqësore janë të nevojshme edhe nëse një prodhues kërkohet të sigurojë të gjitha sipërfaqet në një program specifik.

Përveç kësaj, duhet të regjistrohen përshkrimet e produkteve të sigurimit të përzgjedhura për secilën kulturë bujqësore të mbuluar, mbulimin dhe përzgjedhjet e zbritjeve, përzgjedhje e bashkëpagesave dhe dispozita të tjera speciale.

4.1.2. Përcaktimi i detyrimit: Është e nevojshme të merret informacion në lidhje me detyrimin total të lidhur me çdo kontratë që e ka blerë prodhuesi. Detyrimi total mund të përcaktohet vetëm nëse identifikohen faktorët e mëposhtëm:

- Përshkrim i çdo sipërfaqeje të mbjellë për çdo kulturë bujqësore;
- Të dhënat e rendimentit historik për secilën sipërfaqe specifike dhe për çdo kulturë bujqësore për të gjitha sezonat e kultivimit. Këto të dhëna duhet të përfshijnë rendimentet për vitet e njëpasnjëshme për kulturat bujqësore që mbillen për çdo vit. Për prodhimet rotative, nevojiten rendimentet për sezonet e njëpasnjëshme të kultivimit. Dhe, në rastet që përfshijnë më shumë se një kulturë bujqësore brenda një sezoni të rritjes, nevojiten edhe të dhënat e rendimentit për sezonat e njëpasnjëshme të rritjes;
- Të dhënat e të ardhurave historike dhe shpenzimeve të faktorëve të prodhimit nëse ofrohen të ardhurat e tërë fermës së produkteve të marzhës;
- Praktikat e menaxhimit të zbatuara në fermë duke përfshirë kohën e aktiviteteve në fushë.

4.1.3. Praktikat më të mira të menaxhimit: Një shumëllojshmëri e praktikave të menaxhimit duhet të dokumentohen si pjesë e aktiviteteve të mbledhjes së të dhënave. Për shembull, dokumentacioni është i nevojshëm për:

- Praktikat e ujitjes, duke përfshirë dëshmitë se ujitja është kryer në kohën dhe mënyrën e duhur;
- Datat e mbjelljes, që mund të përfshijnë dokumentacionin që një kulturë bujqësore nuk është mbjellë shumë herët gjatë një sezoni të rritjes (që mund të shkaktojë dëmtim nga ngrica) dhe as tepër vonë (që mund të ketë si rezultat shumë pak ditë për pjekjen e kulturës bujqësore);
- Të dhënat e përfundimit për praktikatat e kërkuara siç janë përdorimi i plehut dhe herbicideve, nëse kjo është praktikë e kërkuar e prodhimit;
- Data e korrjes së kulturave bujqësore.

4.1.4. Inicimi i ankesave: Që një program sigurimi bujqësor të mbetet i realizueshëm, prodhuesit duhet t'i raportojnë rendimentet për çdo sezon të rritjes pa marrë parasysh nëse ata përgatisin kërkesë për humbje. Kjo praktikë është e nevojshme në mënyrë që historia e rendimentit të prodhuesit të përditësohet. Nëse inicohet kërkesa për kompensim, atëherë prodhuesit duhet t'i raportojnë rendimentet në atë kohë; ato duhet të verifikohen gjatë procesit të korrigjimit të humbjes. Nëse nuk inicohet kërkesa për kompensim, rendimentet mund të raportohen pas korrjes nga prodhuesi ose kur nënshkruhet kontrata tjetër e sigurimit. Sidoqoftë, prodhuesit duhet të jenë në gjendje t'i dokumentojnë rendimentet, dhe duhet të zhvillohen procese për ta verifikuar dokumentacionin.

Është gjithashtu e rëndësishme të ketë një sistem që kontrollon rendimentet e raportuara në krahasim me informacione të tjera të paanshme. Për shembull, disa programe të sigurimeve bujqësore kontrollojnë rendimentet nga një mostër e fermave pa marrë parasysh a janë iniciuar apo jo kërkesat për kompensim. Korrigjuesit e humbjeve pastaj i vizitojnë ato ferma gjatë sezonave të korrjes për ta vlerësuar rendimentin aktual. Rendimentet e raportuara pastaj krahasohen me ato të vlerësuar nga korrigjuesi i humbjeve. Këto metoda ndihmojnë në stimulimin e raportimit të saktë.



4.2. Të dhënat e sistemit të sigurimeve bujqësore

Shumë lloje të të dhënave duhet të regjistrohen dhe zhvillohen brenda sistemeve të sigurimeve bujqësore, duke përfshirë:

- Kërkesat e përshtatshmërisë për ta përcaktuar nëse një fermer ka të drejtë të blejë një produkt. Këto kërkesa të përshtatshmërisë përcaktohen nga ofruesi i sigurimeve dhe/ose agjencia rregullative që e mbikëqyr sigurimin;
- Primet dhe opsionet e mbulimit të ofruara nga kompania e sigurimit dhe/ose agjencia qeveritare që e zhvillon produktin;
- Verifikimi në terren dhe verifikimi i të dhënave vjetore të prodhimit të ofruara nga sistemi i sigurimit të kulturave bujqësore nëpërmjet përdorimit të korigjuesve të humbjeve dhe inspektorëve të kulturës bujqësore;
- Shuma të kompensimit dhe bashkë-tarifat ose zbritjet e primit, të cilat duhet të përshkruhen qartë nga ofruesit e sigurimeve;
- Shkaqet e pasiguruara të humbjes. Informata të tilla mund të ofrohen nga korigjuesit e humbjeve dhe inspektorët e kulturave bujqësore dhe janë kritike për azhurnimin e saktë të historive të rendimentit ose përcaktimin nëse nevojiten ndryshime në dizajnin e programit ose produktit.

4.3. Të dhënat e palëve të treta

Të dhënat e palëve të treta janë shumë të nevojshme për vlerësimin e vlerave të kulturave bujqësore dhe, në rastet e produkteve të marzhit ose të sigurimit me vlera të përafërta, identifikimi i kostove ose sasive të faktorëve të prodhimit. Do të thotë, shpenzimet e kompensimit të një humbjeje të rendimentit duke zëvendësuar mallrat fizike janë pengesë. Në anën tjetër, humbjet e rendimentit "zëvendësohen" në mënyrë më efikase duke përdorur ekuivalentë monetarë. Sidoqoftë, problemet e rrezikut moral lidhur me çmimet individuale të kulturave bujqësore janë tepër të mëdha për zhvillimin e produkteve të përbalueshme të sigurimit të kulturave bujqësore. Prandaj, humbjet e rendimentit duhet të vlerësohen përmes përdorimit të të dhënave të çmimeve që nuk mund të ndryshohen nga asnjë individ, por që pasqyrojnë vlerat e arsyeshme në çdo produkt dhe rajon. Prandaj, të dhënat e palëve të treta përdoren shpesh për të përcaktuar çmimet e mallrave dhe të faktorëve të prodhimit.

Në shumë raste, të dhënat e palëve të treta nuk janë gjithmonë në dispozicion për një rajon apo shtet të dhënë. Në këto raste, të dhënat shpesh merren nga shtetet e tjera. Megjithatë, kjo praktikë paraqet si problem ndryshueshmërinë e kursit të këmbimit valutor në llogaritjet e kompensimit. Për më tepër, ekziston rreziku i konsiderueshëm i bazës ndërmjet shteteve, dhe ky rrezik mund të jetë mjaft i ndryshueshëm gjatë gjithë vitit të dhënë.

Të dhënat e palëve të treta shpesh merren nga satelitët dhe stacionet e motit. Observimet në lidhje me reshjet, temperaturën dhe rritjen e vegjetacionit shpesh përdoren si vlera të përafërta për rendimentet. Megjithatë, vlera e këtyre observimeve jo vetëm që varet nga korrelacionet e tyre me rendimentin aktual, por edhe nga të dhënat e pandërprera. Satelitët dhe stacionet e motit mund të kenë prishje mekanike ose elektronike. Kjo mund ta pengojë azhurnimin dhe plotësinë e të dhënave. Përveç kësaj, këto ndërprerje mund të kenë si rezultat llogaritjet dhe pagesat e vonuara të kompensimit. Në fund, mbështetja tek vetëm një palë e tretë për të dhëna kritike është e rrezikshme, pasi prishjet katastrofike të programeve mund të ndodhin nëse ndryshimet e politikave publike ose korrumpimi brenda menaxhimit të këtyre burimeve kufizon qasjen në të dhëna.

4.3.1. Çmimet e mallrave: Ekzistojnë një varg burimesh të palëve të treta për përcaktimin e çmimeve të mallrave, duke përfshirë:

- Burimet e Qeverisë Kombëtare (p.sh., Ministria e Bujqësisë, Shërbimi Kombëtar i Statistikave, Zyra e Regjistrimit, Byroja e Analizave Ekonomike, Zyra e Doganave dhe Akcizave, Shërbimi i Ardhurave të Brendshme etj.);
- Shkëmbimet e Tregut të Mallrave (p.sh. Shkëmbimi i Mallrave në Uinipeg, Shkëmbimi i Mallrave të Çikagos, Këmbimi i Drithërave në Minneapolis, Bordi i Tregtisë i qytetit Kansas, SAFEX, Tregtia e Këmbimeve e Afrikës, Tregtimi dhe Këmbimi i Kontratave të Ardhme i Brazilit, NYSE Liffe, Këmbimi i Letrave me Vlerë i Australisë, Këmbimi i Drithërave i Tokios);
- Sondazhet e tregut lokal;
- Organizatat e fermave.

Megjithatë, çmimet duhet të jenë relevante ose të kenë korrelacion të lartë me çmimet e produkteve të siguruar. Për shembull, Këmbimi i Drithërave i Mineapolisit ofron të dhëna të tregut të kontratave të ardhme (futures) për grurin pranveror me 13.5% proteina. Megjithatë, prodhohen shumë klasa të tjera të grurit, dhe çmimet për to duhet të vlerësohen. Përveç kësaj, çmimet e tregut të kontratave të ardhme për çdo muaj të caktuar ndryshojnë në çdo minutë, dhe kontratat mujore përfundojnë gjatë vitit. Përveç kësaj, çmimet e tregjeve të kontratave të ardhme për ofrimin e një malli në korrje mund të ndryshojnë shumë ndërmjet kohës kur nënshkruhet kontrata e sigurimit bujqësor dhe kohës kur ndodh korrja. Rrjedhimisht, është e rëndësishme të përcaktohen metodat e sakta që duhen përdorur gjatë përdorimit të të dhënave të palëve të treta.

4.3.2. Çmimet e faktorëve të prodhimit: Produktet e marzhës kërkojnë informacion për çmimin e faktorëve të prodhimit të tilla si energjia, plehrat, makineritë dhe pajisjet, ushqimi i kafshëve, punëtorët, shërbimet me kontrata etj. Jo vetëm që këto çmime janë shumë të ndryshueshme përgjatë viteve, rajoneve dhe cilësisë së faktorëve të prodhimit, por shpesh është e vështirë të merret burimi konsistent i atyre çmimeve. Varësisht nga çmimi i faktorëve të prodhimit për të cilin ka interes, burimet janë:

- Qeveritë Kombëtare (p.sh., Ministria e Bujqësisë, Shërbimi Kombëtar i Statistikave, Zyra e Regjistrimit të Analizave Ekonomike, Zyra e Doganave dhe Akcizave, Departamenti i Punës etj.);
- Shkëmbimet e Tregut të Mallrave (p.sh. Shkëmbimi Tregtar i Nju Jorkut, Bursa e Tregtisë e Afrikës, APX-ENDEX, Shkëmbimi Evropian i Energjisë, Shkëmbimi i Letrave me Vlerë i Australisë);
- Sondazhet e tregut lokal.

4.3.3. Të dhënat e indeksit të përafërt: Produktet e Indeksit të vlerës së përafërt nuk i masin direkt humbjet e rendimenteve. Kompensimet aktivizohen kur disa vlera të përafërta për rendimentin nuk i arrijnë objektivat specifike. Për shembull, produktet e indeksit të vlerës së përafërt mund të sigurojnë kundër reshjeve, temperaturës dhe rezultateve të rritjes së bimëve, të cilat ose tejkalojnë ose nuk i arrijnë nivelet e caktuara.

Masa të tilla shpesh merren nga stacionet e motit ose imazhet satelitore. Megjithatë, ka probleme kur përdoren të dhëna të tilla. Të dhënat e stacioneve të motit mund të mos raportohen në mënyrë konsistente ose mund të kenë ndërprerje. Përveç kësaj, korrelacioni i këtyre të dhënave me rezultatet aktuale të mikro-klimës mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Në fund, një numër problemesh mund të shfaqen me përdorimin e imazheve satelitore, si mbulimi me re dhe kushtet e tjera atmosferike që mund të ndikojnë në saktësinë e matjeve.

Pajisjet satelitore dhe sinjalet digjitale u nënshtrohen zhvlerësimit dhe degradimit. Përveç kësaj, satelitët kanë kohëzgjatje të kufizuar të shërbimit dhe mund të mos ketë plane për zëvendësimin fizik ose azhurnimin e softuerit. Për më tepër, për leximet satelitore duhet në fillim të krahasohen me rendimentin aktual. Këto krahasime mund të kenë nevojë të ndryshojnë me kalimin e kohës për shkak të ndryshimeve në funksionet mekanike dhe orbitat satelitore. Kalibrimi dhe variacionet e orbitave mund të ndikojnë në konsistencën dhe dobinë e të dhënave nga burimet satelitore. Prandaj, sistemet e të dhënave të bazuara në këto palë të treta duhet të përshtaten me këto ndryshime. Në fund, kanali i bartjes së të dhënave duhet gjithashtu të jetë i besueshëm që transferimi të mos ndërpritet nga problemet mekanike, politike ose të korrupsionit.

Të dhënat e motit mund të merren nga sistemi i Përmbledhjes Globale të Ditës (GSOD) ose nga rrjeti Global i Historisë së Klimës - Ditore (GHCND). Të dhënat e GSOD-it janë pa pagesë për përdoruesit jo-komercialë dhe nxirren nga të dhënat globale të integruara të sipërfaqes. Aktualisht është në dispozicion informacioni nga mbi 9,000 stacione të motit. Disa nga këto stacione kanë raportuar të dhëna që nga viti 1929. Këto stacione kanë shumë aeroporte dhe lokacione në qytete në mbarë botën. Observimet e ndryshme ditore përmbledhëse si temperatura, pika e vesës, shpejtësia e erës, presioni i ajrit, dukshmëria dhe reshjet mblidhen nga sistemi GDOD. Të dhënat azhurnohen çdo ditë brenda një deri në dy ditë pas datës së observimit.

Baza e të dhënave GHCND jep të dhëna historike ditore të motit mbi zonat globale të tokës. Ajo raporton një përmbledhje të të dhënave të klimës nga burime të shumta që bashkohen para se të rishikohen për sigurim të cilësisë. Arkivat e të dhënave përfshijnë temperaturat maksimale ditore, temperaturat minimale ditore, temperaturat në kohën e observimit, reshjet (ekuivalentët në ujë të reshjeve të shiut dhe borës), reshjet e borës dhe thellësinë e borës; Disa të dhëna të GHCND-së shkëmbehen në Programin Botëror të Vrojtimit të Motit të Organizatës Botërore Meteorologjike (WMO) siç përcaktohet nga Rezoluta 40 e WMO-së. Vendet anëtare të WMO-së mund ta kufizojnë përdorimin e këtyre të dhënave për qëllime komerciale jashtë vendit pranues.

Të dhënat historike të motit shpesh përmbajnë observime joreale, mungesa të observimeve dhe gabime të

tjera. Kjo kërkon që të dhënat e motit të kontrollohen me kujdes para se të përdoren për vlerësim dhe sigurim. Vëzhgimet që mungojnë duhet të korrigjohen në mënyrë adekuate dhe vlerat joreale ekstreme duhet të ndryshohen për të shmangur gabimet e vlerësimit.

Grupet e të dhënave të motit përmbajnë një numër të madh të observimeve. Për shembull, nëse janë në dispozicion pesëdhjetë vite të të dhënave ditore, atëherë 18,000 observime për secilën variabël të matur janë në dispozicion për një lokacion individual të motit. Rrjedhimisht, proceset kompjuterike të automatizuara duhet të menaxhojnë, azhurnojnë dhe procesojnë këtë numër të madh të observimeve.

5.0. Dosjet e të dhënave dhe informatave

Përveç qasjes në sasi të mëdha të të dhënave cilësore për vlerësim dhe kompensim, programet e suksesshme të sigurimeve bujqësore duhet të menaxhojnë informata mbi prodhuesit individualë. Sistemet informative të menaxhimit nuk duhet të zhvillohen vetëm për ta regjistruar informacionin e rendimentit me efikasitet, por një bollëk dokumentacioni është gjithashtu i nevojshëm për qëllime verifikimi dhe administrative. Megjithëse mund të përdoren një sërë metodash, është e dobishme të merren parasysh detajet e një shembulli specifik për ta ilustruar qëllimin dhe fushën e nevojave për dokumentacion. Sistemet informative të menaxhimit duhet të jenë të dizajnuara për të llogaritur realitetet operationale, për të siguruar nevojat e sistemit të sigurimit të kulturave bujqësore dhe për të qenë në përputhje me dizajnin dhe sigurimin e produktit.

5.1. Një shembull nga Shtetet e Bashkuara

Programi i sigurimeve bujqësore të SHBA-ve përdor shumë procese të mbledhjes së të dhënave. Agjencitë lëshuese të sigurimeve ndërtojnë një dosje të të dhënave dhe e bartin atë te agjencitë qeveritare në periudha të caktuara kohore. Varësisht nga pjesëmarrja, mund të ndërtohen shumë dosje për një prodhues individual.

Këto dosje janë konfidenciale dhe dorëzohen për çdo vit kur blihet sigurimi. Duke pasur parasysh nivelin e përpjekjes, është e rëndësishme që sistemet informative të menaxhimit të vlerësohen tërësisht që të dhënat të organizohen në mënyrë efektive që nga fillimi i programit.

Ekzistojnë nëntë dosje primare dhe disa të dhëna të tjera të vogla që përdoren në sistemin amerikan. Gjithsej, çdo kontratë përmban 435 fusha potenciale primare të të dhënave edhe pse disa fusha janë të dyfishuara. Tabela 5.1 paraqet nëntë llojet e dosjeve të përdorura në Shtetet e Bashkuara dhe numrin përkatës të fushave të të dhënave për secilin prej tyre. Tabela gjithashtu jep indeksin e emrit të dosjeve të lidhur me secilin lloj dhe një përshkrim të shkurtër të përmbajtjes së llojit të dosjes.

Tabela 5.1. Llojet e dosjeve të SHBA-ve

Lloji i dosjes	Emri i dosjes	Përshkrimi	Numri i fushave të të dhënave të marra të prodhuesit
10	Regjistri i polisës	Të dhënat e prodhuesit	46
11	Regjistri i sipërfaqes	Të dhënat e polisës	93
12	Regjistri i pagesave	Pagesa e primit të polisës Detajet	12
15	Regjistri i rendimentit	Të dhënat historike të siguruara	93
20	Regjistri total i humbjeve	Pagesa e humbjes ose kompensimit Histori	35
21	Linja e humbjes	Të dhënat dhe shkaku i humbjes	82



25	Pagesa/ Arbitrimi	Regjistri i apelimit	17
55	Të dhënat e agjentit	Përshkrimi i agjentit	40
56	Të dhënat e korigjuesit të humbjes	Përshkrimi i korigjimit të humbjes	25

Shumica e këtyre llojeve të dosjeve përdoren për qëllime administrative, të vlerësimit ose aktuariale dhe nuk ndryshojnë brenda një viti të caktuar për produkte specifike. Megjithatë, regjistrimi i këtij dokumentacioni është me rëndësi kritike për shmangien dhe zgjidhjen e kontesteve. Lloji më i rëndësishëm i dosjes për këtë manual është lloji i dosjes 10. Një shembull i llojit të tipit 10 është paraqitur në Tabelën 5.2. Lloji i dosjes 10 përmban dyzet e gjashtë fusha, disa prej të cilave janë thjesht të zbrazëta për ta ruajtur integritetin e dosjes. Gjithsej tridhjetë e tetë fusha përmbajnë të dhëna të përdorshme.

Në vijim është një përshkrim i secilës fushë:

- **Fusha 1:** Lloji i regjistrimit. Kjo fushë duhet të plotësohet me një "10" për këtë lloj të dosjes.
- **Fusha 2:** Ofruesi i aprovuar i sigurimeve. Një kod me dy shifra që përfaqëson emrin e ofruesit të sigurimeve.
- **Fusha 3:** Vendndodhja Shteti. Një kod me dy shifra për secilën prej pesëdhjetë shteteve të SHBA-ve.
- **Fusha 4:** Kompania e lëshimit të polisave. Në disa raste, një ofrues sigurimi i aprovuar e nënkontraktin një kompani tjetër për lëshimin e polisave. Kjo fushë mundëson që të regjistrohet ky informacion.
- **Fusha 5:** Numri i polisës. Një numër 7 shifror i polisës duhet të caktohet për çdo polisë të veçantë. Prandaj, një prodhues i vetëm mund të ketë disa numra të polisave dhe, për këtë arsye, disa lloje 10 për çdo vit të dhënë.
- **Fusha 6:** Viti i kultivimit. Vitet e kulturave bujqësore zakonisht përkrijnë me vitin kur lëshohet kontrata e sigurimit. Përrjashtimi ndodh me kulturat dimërore ku një kulturë mbillet në një vit, por nuk korret deri në vitin e ardhshëm.
- **Fusha 7:** Lloji 10 Rezerva kryesore. Fusha 7 aktualisht është e rezervuar për përdorim të ardhshëm.
- **Fusha 8:** Numri i regjistrimit. Vlera "001" futet kur një individ ka "interes të konsiderueshëm biznesi" në një kulturë bujqësore, që përcakton të paktën 10% të interesit të biznesit në atë kulturë bujqësore. Nëse përfshihet ndarja e qirasë së kulturës bujqësore qiradhënës/qiramarrës 1/3-2/3, atëherë prodhuesi do të kishte 66% të interesit të biznesit në atë kulturë bujqësore. Në këto raste, qiradhënësit dhe qiramarrësit do të kishin lloje të dosjes 10 të ndara.
- **Fusha 9:** Zyra e degës. Shumë kompani të sigurimeve bujqësore kanë degë. Kjo fushë tregon lokacionin e degës ku është shitur polisa.
- **Fusha 10:** Lloji i identifikimit. Kjo fushë tregon llojin e numrit të identifikimit personal që përdoret nga blerësi. Në Shtetet e Bashkuara ky numër zakonisht është numri i sigurimit social, por mund të përdoren edhe numra të tjerë të identifikimit.
- **Fusha 11:** Numri ID. Kjo fushë plotësohet me një numër të identifikimit për personin që e ka blerë kontratën.
- **Fusha 12:** Lloji i subjektit. Tregon llojin e pronësisë që ekziston në pronën për të cilën është blerë kontrata. Shembujt përfshijnë "korporatë", "C" dhe "individuale", l.
- **Fusha 13:** Mbiemri i prodhuesit. Mbiemri i blerësit.
- **Fusha 14:** Emri i prodhuesit. Emri i blerësit.
- **Fusha 15:** Emri i mesëm i prodhuesit. Emri i mesëm i blerësit.
- **Fusha 16:** Prapashtesa e emrit të prodhuesit. Prapashtesa e blerësit (nëse ka).
- **Fusha 17:** Titulli i prodhuesit. Titulli i blerësit (nëse ka).
- **Fusha 18:** Emri i Biznesit. Emri i biznesit të blerësit (nëse ndryshon nga emri i blerësit).
- **Fusha 19:** Adresa rreshti 1. Adresa kryesore e blerësit.



- **Fusha 20:** Adresa rreshti 2. Informacione shitesë të adresës (nëse ka).
- **Fusha 21:** Qyteti. Adresa e qytetit të blerësit.
- **Fusha 22:** Shteti. Adresa e shtetit të blerësit.
- **Fusha 23:** Kodi Postar. Kodi postar i blerësit.
- **Fusha 24:** Numri vazhdues i kodit postar. Numri vazhdues i kodit postar të blerësit.
- **Fusha 25:** Numri i telefonit. Numri i telefonit të blerësit.
- **Fusha 27:** Shenja SBI për mos-kualifikim. Nëse një "Y" shënohet në këtë fushë, atëherë aplikuesi nuk ka të drejtë ta blejë këtë polisë. Personi mund të mos kualifikohet për shkak të dënimeve të mëparshme për mashtrim në sigurime.
- **Fusha 28:** Plotësues. Duhet të jetë e zbrazët.
- **Fusha 29:** Pjesa SBI për mos-kualifikim. Përqindja nuk kualifikohet nëse "Y" shënohet në Fushën 27.
- **Fusha 30:** ID e përbashkët e klientit të USDA. E rezervuar për përdorim të brendshëm në lidhje me kualifikimin.
- **Fusha 31:** Shenja SBI që nuk mund të sigurohet. Përdoret në rastet kur nuk është dhënë një numër valid i identifikimit.
- **Fusha 32:** Plotësues. Duhet të jetë e zbrazët.
- **Fusha 33:** Pasardhësi i interesit. Tregon pasardhësin e interesit të cilit do t'i dërgohet çeku për pagesën e kompensimit nëse blerësi vdes gjatë vitit.
- **Fusha 34:** Numri i mëparshëm i polisës. Përdoret për rastet në të cilat një pasardhës i interesit ka qenë në vitet e mëparshme.
- **Fusha 35:** Plotësues. Duhet të jetë e zbrazët.
- **Fusha 36:** Shenja e validimit SSN. Përdoret për ndryshimin e numrit të brendshëm të sigurimit social.
- **Fusha 37:** Flamuri i shërbimit të matjes. Indikator i faktit nëse sipërfaqja është matur në të vërtetë apo nëse po përdoret vlerësimi i prodhuesit për sipërfaqen.
- **Fusha 38:** Plotësues. Duhet të jetë e zbrazët.
- **Fusha 39:** Koha e kontrollit të FCIC. Përdorimi i brendshëm.
- **Fusha 40:** Data e kontrollit të FCIC. Përdorimi i brendshëm.
- **Fusha 41:** Viti i risigurimit. Përdorimi i brendshëm.
- **Fusha 42:** Numri i grupit. Përdorimi i brendshëm.
- **Fusha 43:** Sekuenca e transaksionit. Përdorimi i brendshëm.
- **Fusha 44:** Flamuri i refuzuar i transaksionit. Përdorimi i brendshëm.
- **Fusha 45:** Shenja e burimit të transaksionit. Përdorimi i brendshëm.
- **Fusha 46:** Plotësues. Duhet të jetë e zbrazët.

Dosjet e llojit 10 dokumentojnë dhe identifikojnë blerësin e një kontrate specifike. Dosjet e llojit 11 regjistrojnë informacione për sipërfaqen, duke përfshirë identifikimin e parcelave të tokës. Dosjet e llojit 12 dokumentojnë pagesat e primit, ndërsa dosjet e llojit 15 i regjistrojnë historitë e rendimentit. Dosjet e llojit 20 dokumentojnë humbjet dhe pagesat e kompensimit dhe dosjet e llojit 21 dokumentojnë humbjet dhe shkaqet e tyre. Dosjet e llojit 25 përdoren për zgjidhjen e kontesteve, dhe dosjet e llojit 55 dhe 56 japin të dhëna për agjentin e sigurimit dhe respektivisht korrigjuesin e humbjes. Dokumentacioni lidhur me këto dosje mund të gjendet në: <http://www.rma.usda.gov/data/m13/>.

Diskutimi dhe shembujt e mësipërm ilustrojnë disa pika. Së pari, të gjitha programet e sigurimit të kulturave bujqësore duhet të menaxhojnë një bollëk të dhënash dhe dokumentacionit. Së dyti, nevojitet shumë planifikim për të funksionalizuar programe të tilla. Së treti, programet e suksesshme të sigurimit të kulturave bujqësore rriten dhe ndryshojnë. Sistemet e menaxhimit të të dhënave duhet t'i përshtaten ndryshimit. Së katërti, sistemi i SHBA-ve është relativisht i ngathët si rezultat i rritjes dhe ndryshimeve teknologjike që nga fillimi i programit. Kur sistemi ka filluar, përdorimi i kompjuterit ishte në fillimet e tij dhe më së shumti mbajtja e regjistrave ishte me kopje të letrës. Ndërsa nevojat për të dhëna u rritën dhe teknologjia ndryshoi, sistemi duhej të përshtatej me përdorimin e bazave elektronike të të dhënave. Sisteme më të mira mund të zhvillohen duke përdorur teknologjinë aktuale, por fleksibiliteti duhet të ndërtohet në ato sisteme.

Tabela 5.2. Regjistri i polisave FCIC –
Dosja e llojit 10

Numri i fushës	Emri i fushës	Pozita fillestare	Madhësia	Fotografia	Ndryshimet e fushës
1	Lloji i regjistrit	1	2	9(02)	Kërkohet. Duhet të jetë 10.
2	Sigurimi i aprovuar Ofrohet	3	2	X(02)	Kërkohet. Ndrysho me AIP/Tabelën e kompanisë.
3	Lokacioni Shteti	5	2	9(02)	Kërkohet. Ndrysho me FIPS tabelën e shteteve.
4	Kompania lëshuese e polisës	7	3	9(03)	Kërkohet. Ndrysho me tabelën e kompanisë. Duhet të jetë PIC kodi i vlefshëm për vitin e risigurimit.
5	Numri i polisës	10	7	9(07)	Kërkohet. Duhet të jetë > zero.
6	Viti i kulturës	17	4	9(04)	Kërkohet. Duhet të jetë viti i kulturës i kulturave të raportuara në atë polisë. Ky do të mbetet viti i risigurimit ose viti i risigurimit +/- 1 për kodin përkatës të kulturës bujqësore.
7	Rezerva e llojit 10	21	55	X(55)	Hapësira e rezervuar për të dhëna shtesë që kërkohen në të ardhmen ose për lloje tjera të regjistrave.
8	Numri i regjistrit.	76	3	9(03)	Kërkohet. Duhet të jetë > zero. Vetëm një numër regjistri "001" lejohet. Numrat e regjistrit 002-999 përdoren për të raportuar subjektet SBI.
9	Zyra e degës.	79	2	X(02)	Kërkohet. Zyra e degës së organizatës së risiguruar për regjistrin 001. Regjistri 002 ose më i madh duhet të jetë hapësirat.
10	Lloji i identifikimit.	81	1	9(01)	Kërkohet. Duhet të jetë një nga të mëposhtmet: 1 = SSN, 2 = EIN, 3 = RMA e caktuar, 5 = Numri BIA. (Shih Shembullin 10-1 për kombinimet valide)
11	Numri i identifikimit.	82	9	X(09)	Kërkohet. Duhet të jetë një nga të mëposhtmet: 1 = SSN (numerik), 2 = EIN (numerik, > zero), 3 = RMA i caktuar (MGR-05-008), 5 = Numri BIA (mund të jetë alfanumerik). (Shih Shembullin 10-1 për kombinimet valide) Shih shënimin në fund lidhur me raportimin për SSN të jo-shtetasve.

12	Lloji i subjektit	91	1	X(01)	<p>Kërkohet. Duhet të jetë një nga të mëposhtmet: A = Shkollat publike, B = Zyra e çështjeve indiane C = Korporata, D = Pronat e patundshme E = Shoqatat, klubet, shkollat private, dhe/ose organizatat që përjashtohen nga tatimi (fetare) F = transferi i të drejtës për kompensim (vetëm SBI) G = Pranuesi ose likuiduesi, H = Agjencia publike – shteti I = Individual J = Operatorët e përbashkët/bashkë-pronarët/organizatat e përbashkëta L = Qiradhënësi/Qiramarrësi (vetëm SBI), P = Ortakëria R = Trustet e revokueshme, S = bashkëshortore – e martuar T = Trustet e parevokueshme U = Interesat e pandara valide vetëm për mbulimin e kat V = Agjenci publike – Qarku, W = Agjencia publike X = Individ që vepron si kompani Y = Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) (Shih Shembullin 10-1 për kombinimet valide)</p>
13	Mbiemri i prodhuesit.	92	20	X(20)	<p>Kërkohet nëse fusha 18 (emri i biznesit) është e zbrazët. E rreshtuar majtas. Përdoret vetëm për emrat personalë Regjistrimet kërkojnë së paku 2 karaktere. Vetëm një emër për fushë. Alfa duke përfshirë (-), (.), (), (*), (,).</p>
14	Mbiemri i prodhuesit.	112	10	X(10)	<p>Kërkohet nëse fusha 13 nuk është e zbrazët. E rreshtuar majtas. Përdoret vetëm për emrat personalë Vetëm një emër për fushë. Për subjektin e llojit 'J' mund të jenë dy emra. Alfa duke përfshirë (-), (.), (), (*), (,).</p>
15	Emri i mesëm i prodhuesit.	122	10	X(10)	<p>Opsionale. Rreshtuar majtas nëse raportohet. Alfa duke përfshirë (-), (.), (), (*), (,). Lihet e zbrazët nëse nuk raportohet.</p>

16	Prapashtesa e emrit të prodhuesit.	132	5	X(05)	Opsionale. Rreshtuar majtas nëse raportohet. Prapashtesa e emrit të prodhuesit (p.sh., SR, JR, II, etj.). Alfa duke përfshirë (-), (.), (), ('), (,). Përndryshe, hapësirat.
17	Titulli i prodhuesit.	137	4	X(04)	Opsionale. Rreshtuar majtas nëse raportohet. Titulli i prodhuesit (p.sh., MR, MRS, DR, etj.). Alfa duke përfshirë (-), (.), (), ('), (,). Përndryshe, hapësirat.
18	Emri i Biznesit	141	35	X(35)	Kërkohet nëse fusha 13 është e zbrazët. E rreshtuar majtas. Përdoret për të gjitha llojet e subjekteve përveç personave individualë. Alfamerike Duke përfshirë (-), (.), (), (), ('), (&), (%), (), (+), (#).
19	Adresa rreshti 1.	176	35	X(35)	Kërkohet. E rreshtuar majtas. Alfamerike duke përfshirë (-), (.), (.), (), (&), (%), (#), (/).
20	Adresa rreshti 2.	211	35	X(35)	Opsionale. E rreshtuar majtas. Alfamerike duke përfshirë (-), (.), (.), (), (&), (%), (#), (/). Përndryshe, hapësirat.
21	Qyteti	246	35	X(35)	Kërkohet. Nëse kodi i shtetit = ZZ shëno qytetin e huaj dhe shtetin. E rreshtuar majtas.
22	Adresa shteti	281	2	X(02)	Kërkohet. Shëno shkurtësën e shtetit me shkronja Nëse shtet i huaj, shëno ZZ.
23	Kodi Postar	283	5	9(05)	Kërkohet nëse shteti NE ZZ. Duhet të jetë kod postar valid i SHBA-ve.
24	Numri vazhdues i kodit postar	288	4	9(04)	Opsionale. Përndryshe, shëno zero.
25	Numri i telefonit	292	10	9(10)	Kërkohet. Nëse nuk ka numër telefoni, shëno të gjitha pesëshe.
27	Shenja SBI për mos-kualifikim	303	1	X(01)	Vetëm për regjistrat e SBI. Numri i regjistratit duhet të jetë i barabartë me ose më i madh se 002. Shëno Y nëse subjekti SBI nuk kualifikohet dhe është zvogëluar pjesa. Përndryshe, leje të zbrazët.
28	Plotësues.	304	2	X(02)	Duhet të jetë hapësira.
29	Pjesa SBI nuk kualifikohet	306	4	9(01) v9(03)	Kërkohet. Për regjistrat e SBI vetëm me shenjë të mos-kualifikimit SBI prej Y. Duhet të jetë > 0% dhe ≤ 1.000. Numri i regjistratit duhet të jetë ≥ 002. Duhet të jetë me zero nëse nuk zbatohet.
30	USDA i përbashkët ID e klientit	310	6	X(06)	E rezervuar.
31	Shenja SBI që nuk mund të sigurohet.	316	1	X(01)	Shëno 'Y' në regjistrin e subjektit primar, regjistri 001, nëse subjekti SBI nuk ka, ose nuk jep, një numër valid identifikimi dhe pjesa është zvogëluar. Përndryshe, hapësira.
32	Plotësues.	317	1	X(01)	Duhet të jetë një hapësirë.
33	Pasardhësi i interesit (SII) Të dhënat e aplikacionit	318	8	9(08)	Data e aplikacionit të pasardhësit të interesit MMDDCCYY formati, përndryshe zero. Vetëm për vitin aktual.
34	SII Numri i mëparshëm i polisës.	326	7	9(07)	Numri i mëparshëm i polisës (i pandryshuar ose i ri) para pasardhësit të interesit. Duhet të jetë > zero nëse zbatohet, përndryshe zero.
35	Plotësues.	333	14	X(14)	Duhet të jetë hapësira.
36	Shenja e validimit SSN	347	2	X(02)	Përdorimi i brendshëm. Do të plotësohet gjatë ndryshimit të SSN.
37	Shërbimi i matjes Shenja	349	1	X(01)	N = Matja e sipërfaqes nuk është dhënë, përndryshe hapësira.
38	Plotësues.	350	201	X(201)	Duhet të jetë hapësira.
39	Koha e kontrollit të FCIC	551	4	9(04)	Përdorimi i brendshëm. Koha kur është pranuar dosja e grupit të transaksionit. (Prej kur ka filluar bartja) HHMM Formatit.

40	Data e kontrollit të FCIC	555	8	9(08)	Përdorimi i brendshëm. Data kur është pranuar dosja e grupit të transaksionit. (Prej kur ka filluar bartja) Format MMDDCCYY.
41	Viti i risigurimit	563	4	9(04)	Përdorimi i brendshëm. Viti i risigurimit. Format CCYY.
42	Numri i grupit	567	4	9(04)	Përdorimi i brendshëm. Numri rendor që identifikon dosjen që është dorëzuar nga AIP te FCIC/RMA.
43	Numri rendor i transaksionit	571	8	9(08)	Përdorimi i brendshëm. Numri rendor i caktuar për secilin numër transaksioni të procesuar nga DAS pasi është klasifikuar.
44	Transaksioni është refuzuar Shenja	579	1	X(01)	E brendshme. E rezervuar.
45	Shenja e burimit të transaksionit.	580	1	X(01)	E brendshme. E rezervuar.
46	Plotësues.	581	20	X(20)	E brendshme.

6.0. Kontrolli i cilësisë

Programet e sigurimeve bujqësore janë shumë të varura nga sasia e madhe e të dhënave dhe informacioni i saktë. Megjithatë, pjesa më e madhe e të dhënave të kërkuara mund të përmbajnë gabime. Prandaj, proceset e kontrollit të cilësisë sa i përket futjes së të dhënave dhe sigurisë duhet të vendosen për të minimizuar gabimet e të dhënave. Qëllimi i procedurave të kontrollit të cilësisë është të sigurohet që produktet, shërbimet ose proceset të përmbushin kërkesat specifike dhe të jenë të besueshme, të kënaqshme, transparente dhe me arsyeshmëri fiskale.

Shumë probleme për menaxhimin e të dhënave lidhen me çështjet e kontrollit të cilësisë në programet e sigurimeve bujqësore. Njoftimet e automatizuara të gabimeve gjatë futjes së të dhënave janë një shembull. Përveç kësaj, duhet të merren në konsideratë çështjet lidhur me bartjen e të dhënave, të dhënat që mungojnë, vlerat ekstreme shmangiet, dhe procedurat për azhurnimin dhe rishikimin e të dhënave, kur vendosen sistemet informative të menaxhimit.

Në fund, duhet të theksohet se observimet e pasakta shpesh kanë ndikime më të mëdha në suksesin e një produkti sesa po të mos ketë fare observime. Kështu, proceset e kontrollit të cilësisë duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë gabimet. Të gjitha të dhënat duhet të analizohen dhe të dhënat e gabuara apo që mungojnë duhet të identifikohen. Në shumë raste, çështjet e cilësisë së të dhënave mund të trajtohen në mënyra të përshtatshme që ruajnë dobinë e informacionit për programet e sigurimeve. Megjithatë, nëse nuk pranohen këto probleme mund të ketë si rezultat sigurimin e dobët dhe norma jo të duhura të primit si dhe komunikim jo konsistent me palët e interesuara.

6.1. Problemet në menaxhimin e të dhënave

Sistemet informative të menaxhimit duhet të zhvillohen për të përfshirë automatikisht kontrollet e cilësisë dhe për të mundësuar kontrollet njerëzore për çështjet e të dhënave. Proceset e automatizuara mundën, për shembull, ta njoftojnë personelin e të dhënave për të dhënat që janë jashtë rangut të arsyeshëm. Prezantimi i shpeshtë i të dhënave në formë grafike ose tabelare gjithashtu mund të identifikojë vlerat ekstreme dhe shmangiet. Proceset grafike dhe statistikore gjithashtu mund të përdoren për të identifikuar të dhënat që janë në trend me kalimin e kohës dhe/ose nëse ndryshimet në observime po rriten apo po zvogëlohen me kalimin e kohës.

Proceset duhet të zhvillohen për bartjen e sigurt, të mbrojtur dhe të saktë të të dhënave ndërmjet palëve të autorizuara. Përveç kësaj, duhet të krijohen kontrolle të duhura dhe të qarta të versioneve, në mënyrë që shtesat e gabuara në dosjet e të dhënave të mund të hiqen lehtësisht. Azhurnimet e softuerëve dhe pajisjeve harduerike duhet të planifikohen në mënyrë që operacionet të mos ndërpriten dhe të ruhet integriteti i të dhënave. Për më tepër, sistemet duhet të zhvillohen në mënyrë që të mos jenë të varura nga një person specifik pasi që të gjitha bizneset duhet të përgatiten për qarkullimin e burimeve njerëzore.

Duhet të zhvillohen procedura për azhurnimin automatik të të dhënave të ndryshme dhe për të përshtatur rishikimet periodike të të dhënave të palëve të treta.

Për më tepër, ndryshimet metodologjike në procedurat e mbledhjes së të dhënave të palëve të treta duhet të monitorohen dhe ndikimet e



tyre potenciale në dizajnin e produktit dhe performancë duhet të vlerësohen.

Efektet e ndryshimeve teknologjike në rendimente duhet të shqyrtohen vazhdimisht. Ndryshimi teknologjik ndodh nëpërmjet zhvillimit të varieteteve të reja gjenetike, makinerive të reja dhe praktikave të avancuara të prodhimit. Ndikimet e ndryshimeve klimatike, rregulloreve t; qeverisë, marrëveshjeve tregtare dhe përdorimit të tokës kanë implikime të rëndësishme edhe për programet e sigurimeve bujqësore. Përveç kësaj, ndryshimi i çmimeve relative të faktorëve të prodhimit mund të ndikojë në rendimente dhe ndryshueshmërinë e rendimenteve.

6.2. Transferi i të dhënave

Shpërndarja e të dhënave është thelbësore për programet e sigurimeve bujqësore për shkak të shumëllojshmërisë së palëve të përfshira në këto programe. Megjithatë, jo çdo palë e interesuar ka nevojë për qasje në të gjitha të dhënat dhe informacionet. Prandaj, siguria dhe konfidencialiteti janë karakteristika të rëndësishme të transferimit të të dhënave.

Transferi i të dhënave dhe informacionit ndodh ndërmjet:

- Fermerëve dhe ofruesve të sigurimeve;
- Ofruesve të sigurimeve dhe agjencive rregullatore ose qeveritare;
- Njësive organizative brenda kompanive të sigurimit;
- Kompanive të sigurimeve dhe risiguruesve.

Mekanizmat për këto transfere janë të ndryshme dhe përfshijnë:

- Transferet fizike përmes postës ose postës së shpejtë;
- Transferet e mbrojtura ose të pambrojtura të të dhënave digjitale nëpërmjet pajisjeve fizike;
- Transferet elektronike të të dhënave digjitale përmes proceseve të koduara ose të pakoduara;
- Teknologjitë e telefonit dhe telefaksit;
- Intranet-et lokale.

Përveç kësaj, duhet t'i kushtohet vëmendje të gjitha palëve të interesuara që kanë të drejta "vetëm për të lexuar" të dhënat kundrejt mundësisë për t'i ndryshuar të dhënat.

6.3. Të dhënat që mungojnë

Natyrë e të dhënave të sigurimit të kulturave bujqësore shpesh ka si rezultat mungesën e observimeve. Observimet që mungojnë ndodhin sepse prodhuesit mund të kenë humbur ose të mos kenë dokumentuar rendimentet në një vit të caktuar, stacionet e motit mund të mos kenë regjistruar informacionin për disa ditë ose raportimi i çmimeve të palëve të treta mund të mos ketë ndodhur vazhdimisht.

Brenda bazave të të dhënave elektronike moderne, të dhënat e tilla që mungojnë në përgjithësi nuk duhet të kodohen me "0".

Për shembull, mund të mungojë një observim i rendimentit, por rendimenti nuk ka qenë në të vërtetë zero. Anasjelltas, sigurisht që është e mundur që zero të jetë vlerë legjitime për një observim të rendimentit. Përveç kësaj, shfaqja sistematike e të dhënave që mungojnë mund të jetë një shenjë që palët e interesuara po përpiqen të fshehin informacione të rëndësishme. Rrjedhimisht, duhet të zhvillohen procedura për të marrë në llogari observimet që mungojnë. Në disa raste, observimet që mungojnë thjesht injorohen. Në të tjerat, një vlerë futet për observimin që mungon. Kjo vlerë mund të merret nëpërmjet interpolimit të të dhënave të afërta, ose mund të jetë një mesatare e observimeve të tjera që kanë qenë në një rajon të ngjashëm dhe në një kohë të ngjashme.





6.4. Vlerat ekstreme

Të dhënat ekstreme (shmangiet) ndodhin për një numër arsyesh në të dhënat e sigurimit të kulturave bujqësore, duke përfshirë gabimet në regjistrim, gabimet e tjera, komunikimin e gabuar dhe procedurat e dobëta të matjes. Varësisht nga vëllimi i të dhënave, grafikët shpesh mund të zbulojnë vlerat ekstreme. Kur vëllimi i të dhënave është i madh, statistikatat përshkruese mund të përdoren për të identifikuar vlerat ekstreme. Përveç kësaj, shqyrtimi i ndryshueshmërisë ndërkohore dhe krahasimi me seritë përkatëse të të dhënave mund të përdoren për të identifikuar shmangiet.

Procedurat duhet të zhvillohen për të marrë në llogari vlerat ekstreme. Në disa raste, kodifikimi i vlerave ekstreme si "të munguara" mund të jetë qasje e arsyeshme. Në raste të tjera, observimet e afërta, korrelacionet me variablat e lidhura, burimet alternative të të dhënave ose interpolimi mund të përdoren për të zëvendësuar vlerat ekstreme me vlera të arsyeshme.

6.5. Trendi i të dhënave

Ndryshimet teknologjike ose të tjera strukturore shpesh janë të lidhura ngushtë me të dhënat bujqësore. Këto ndryshime shpesh manifestohen si trende lineare ose jo lineare. Përveç kësaj, ndryshimet afatshkurtra në politikat bujqësore ose tregtare të qeverisë mund të shkaktojnë ndryshime afatshkurtra në nivelet e çmimeve bujqësore ose, sipas rastit, edhe në rendimente. Trendet mund të identifikohen ose nëpërmjet procedurave grafike ose atyre statistikore.

Trendet duhet të llogariten kur vendosen normat e primit. Nëse trendet shpërfillen, atëherë normat e primit ka gjasa të vendosen shumë të larta dhe/ose nivelet e mbulimit do të jenë më të ulëta se sa pritet. Përveç kësaj, njohja e trendit mund të ndihmojë në identifikimin e ndryshueshmërisë së rendimenteve ose çmimeve.

6.6. Azhurnimi dhe rishikimi i të dhënave

Të dhënat dhe informacioni i kërkuar nga programet e sigurimeve bujqësore duhet të azhurnohen vazhdimisht pasi që informatat e reja vihen në dispozicion. Azhurnimi i informacionit nuk është vetëm i nevojshëm për efikasitetet operacionale, por edhe për vlerësimin e efikasitetit të programeve dhe për rishikimet e sigurimeve. Prandaj, duhet të zhvillohen sisteme për të mundësuar që të dhënat të azhurnohen pa pengesa dhe saktë.

Programet e sigurimeve bujqësore shpesh përdorin sasi të konsiderueshme të të dhënave të palëve të treta. Të dhënat e palëve të treta mund të jenë në formën e informacionit rajonal të rendimenteve apo çmimeve, observimeve të motit ose imazheve satelitore. Përveç azhurnimit të të dhënave kur vihen në dispozicion, të dhënat e palëve të treta shpesh rishikohen. Duhet të krijohen metodologji për të përfshirë rishikimet e të dhënave të pranuar nga palët e treta. Ndikimet e rishikimeve të të dhënave për

vlërësimin, nënshkrimin dhe realizimin e produktit duhet të shqyrtohen me kujdes.

7.0. Qasja dhe siguria e të dhënave

Një element kritik i programeve të suksesshme të sigurimeve bujqësore lidhet me qasjen e të dhënave, sigurinë dhe konfidencialitetin. Fillimisht, këto çështje lidhen me vendimet e politikave publike lidhur me qasjen në të dhëna. Do të thotë, përveç ofruesve të sigurimeve, kompanitë e risigurimit, dizajnerit e produkteve dhe vlerësuesit e programeve duhet të kenë qasje në disa, por ndoshta jo të gjitha, të dhënat e sistemit. Megjithatë, secila prej këtyre grupeve ka nevojën të ndryshme dhe, në shumë raste, duhet të bllokohen nga disa informacione konfidenciale të cilat nuk u nevojiten për qëllimet e tyre.

Në aspektin e zbatimit, vendimet e pajisjeve kompjuterike dhe softuerit duhet të lehtësojnë qasjen e duhur nga grupe të ndryshme. Përveç kësaj, në përzgjedhjen e sistemeve harduerike dhe softuerike duhet të merren në konsideratë kostot, lehtësia e përdorimit, kontrolli i cilësisë, zgjerimi dhe azhurnimi i veprimeve. Në fund, siguria e informacionit dhe kopja rezervë duhet të sigurohen në programe të tilla.

7.1. Siguria e të dhënave

Siguria e informacionit nënkupton mbrojtjen e informacionit dhe sistemeve të informacionit nga përdorimi, qasja, zbulimi, ndërhyrja, modifikimi ose shkatërrimi i paautorizuar. Këto probleme prekin fushat e konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërisë, autenticitetit dhe mos-refuzimit.

7.1.1. Konfidencialiteti: Mbrojtja e konfidencialitetit të informacionit është një praktikë e zakonshme afariste. Mungesa e mbrojtjes bën që bizneset dhe strategjitë të dështojnë nëse klientët humbin besimin dhe konfidencën në llogaridhënien e biznesit. Përveç kësaj, konfidencialiteti është një kërkesë etike dhe ligjore në shumë rajone të botës. Privatësia e informacionit të tillë është një e drejtë dhe kërkesë themelore në shumë shoqëri.

Siguria e informacionit duhet, pra, të mbrojë privatësinë e individëve. Mbajtja e konfidencialitetit domosdo kërkon parandalimin e zbulimit të informacionit tek individët ose sistemet e paautorizuara. Përveç kësaj, privatësia e informacionit personal duhet të ruhet.

7.1.2. Integriteti: Një aspekt tjetër i sistemeve të tilla është se ata duhet të sigurojnë që të dhënat të mos mund të korruptohen nga të tjerët. Sistemet e informacionit duhet të jenë të dizajnuara për të siguruar ruajtjen e integritetit të të dhënave. Integriteti i të dhënave mund të priset në dy mënyra: (1) vjedhja e të dhënave dhe (2) korruptimi i të dhënave.

Integriteti i të dhënave kërkon që të zhvillohen sisteme për të ruajtur të dhënat nga ndryshimi pa autorizim. Integriteti i të dhënave mund të shkelet në shumë mënyra:

- Një punonjës mund të fshijë aksidentalisht dosjet e rëndësishme të të dhënave;
- Viruset kompjuterike mund të infektojnë programet kompjuterike;
- Një përdorues i paautorizuar mund të vandalizojë një faqe interneti duke korruptuar ose fshirë dosje të rëndësishme.

7.1.3. Disponueshmëria: Sistemet informative të menaxhimit duhet ta vendosin në dispozicion informacionin për ata që kanë nevojë për të në kohën e duhur. Në disa raste, individët kanë nevojë për qasje në vetëm një sasi të kufizuar të të dhënave. Përveç kësaj, ndonjëherë mjafton që përdoruesit thjesht t'i shohin të dhënat, dhe të mos i modifikojnë ato. Në raste të tjera, individëve duhet t'u lejojë të shohin vetëm një sasi të



kufizuar të të dhënave.

Në fund, të dhënat duhet të jenë në dispozicion sipas kërkesës. Kjo do të thotë që duhet të mbahen sistemet kompjuterike dhe të vendosen sistemet e sigurisë në mënyrë që qasja e duhur të jetë në dispozicion gjatë gjithë kohës. Sistemet nuk duhet vetëm të funksionojnë si duhet, por duhet edhe të mbrohen nga ndërprerjet për shkak të ndërprerjeve të rrymës, prishjeve të harduerit dhe azhurnimeve të sistemit.

7.1.4. Autenticiteti: Ndërsa shitja elektronike e produkteve të sigurimeve bujqësore bëhet më e zakonshme, është e domosdoshme që blerjet, kërkesat dhe qasja të konsiderohen si të vërteta dhe jo të falsifikuara ose rezultat i imitimeve të paautorizuara. Prandaj, sistemet duhet të jenë të dizajnuara për ta siguruar vërtetësinë e pjesëmarrësve.

7.1.5. Mos-refuzimi: Mos-refuzimi ka nënkupton të siguruarit që blerësit e polisave dhe kompanitë e sigurimeve të përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale. Kjo kërkon që secila palë të mos jetë në gjendje të mohojë pranimin ose urdhërimin e një transaksioni. Prandaj, pjesa më e madhe e tregtisë elektronike përdor nënshkrime digjitale dhe proceset e enkriptimit për të vendosur autenticitetin dhe për të minimizuar mos-refuzimin.

7.2. Qasja, kontrolli dhe transparencia

Qasja në informacionin e mbrojtur duhet të kufizohet vetëm për ata që janë të autorizuar për të parë ose shkarkuar të dhënat e zgjedhura. Duhet të krijohen mekanizmat për ta kontrolluar qasjen në informacionin e mbrojtur. Sofistikimi i mekanizmave të kontrollit duhet të përputhet me vlerën e informacionit që mbrohet. Informacioni më i ndjeshëm ose i vlefshëm kërkon mekanizma më të fortë të kontrollit. Mekanizmat e qasjes dhe kontrollit duhet të marrin parasysh edhe çështjet e transparencës. Edhe mungesa e transparencës në interes të kufizimit të qasjes dhe përmirësimit të kontrollit zvogëlon besimin në programet e sigurimeve bujqësore. Baraspesha ndërmjet kontrollit të qasjes dhe transparencës janë çështje të rëndësishme në dizajnimin e sistemeve të të dhënave.

Themelet mbi të cilat janë ndërtuar mekanizmat e kontrollit të qasjes përfshijnë çështjet që lidhen me identifikimin, vërtetimin dhe autorizimin.

7.2.1. Identifikimi: Duhet të zhvillohen procedurat e të dhënave që e sigurojnë pozitivisht identitetin e atyre që përpiqen të hyjnë në sistemet e të dhënave. Qasja e të dhënave duhet të jepet vetëm me verifikimin e identitetit të personit dhe të drejtat për të parë, shkarkuar ose ndryshuar të dhënat.

7.2.2. Autentikimi: Një larmi e informacionit mund të përdoret për ta vërtetuar identitetin e një personi duke përfshirë:

(1) informacionin që një person e di, (2) diçka që një person ka, ose (3) karakteristika unike fizike (shpesh të quajtura të dhëna biometrike).

Për shembull, informacioni që një person e di do të përfshijë gjëra të tilla si Numër Identifikimi Personal (PIN), fjalëkalim ose një përgjigje e paracaktuar për një pyetje specifike. Gjërat që një person ka përfshijnë patentë shoferi ose kartë magnetike rrëshqitëse. Karakteristikat unike fizike përfshijnë gjërat biometrike, të tilla si gjurmët e gishtërinjve, zëri dhe skanimet e retinës (të syve).

7.2.3. Autorizimi: Programet e sigurimeve bujqësore duhet të zhvillojnë një proces konsistent për përcaktimin e autoritetit të personit për të pasur qasje në informata. Kërkesat e qarta për qasje dhe veprimet që mund të merren nga individët (p.sh., shkarkimi, shikimi, krijimi, fshirja ose ndryshimi i të dhënave) duhet të krijohen me kujdes dhe të reklamohen gjerësisht.

Autorizimi për të hyrë në informata dhe shërbimet e tjera llogaritëse përfshin domosdo vendime në lidhje me politikat dhe procedurat administrative. Për të qenë efektive, politikat dhe kontrollet e tjera të sigurisë duhet të zbatohen në mënyrë konsistente.

8.0. Hardueri, softueri dhe kopja rezervë e të dhënave kompjuterike

Sasia dhe përdorimi i të dhënave në programet e sigurimeve bujqësore kërkon përdorimin e sistemeve informative të menaxhimit të kompjuterit me shpejtësi të lartë dhe të besueshme. Tri elemente duhet të merren parasysh gjatë dizajnit të sistemeve të tilla: (1) hardueri kompjuterik, (2) softueri kompjuterik, dhe (3) sistemet e ruajtjes së kopjes rezervë dhe të operacioneve. Sistemet e pajisjeve harduerike duhet të jenë të besueshme dhe të lehta për t'u mirëmbajtur dhe janë thelbësore kopjet rezervë të të dhënave. Përveç kësaj, të dhënat duhet të jenë në dispozicion gjatë kohës kur sistemet nuk janë funksionale për shkak të ndërprerjeve të rrymës ose gjatë azhurnimeve të sistemit.

8.1. Kërkesat e harduerit dhe softuerit

Vendimet në lidhje me sistemet harduerike dhe softuerike janë elemente të rëndësishme të çdo programi të sigurimeve bujqësore. Përzgjedhja e sistemeve të tilla duhet të shqyrtohet me kujdes para se të nisnin programe të tilla, pasi është e kushtueshme të ndryshohen sistemet pasi programet të kenë filluar. Një sërë kriteresh duhet të merren parasysh në marrjen e këtyre vendimeve, duke përfshirë performancën e sistemit, koston, kapacitetin e ruajtjes, besueshmërinë dhe kopjet rezervë dhe rikthimin pas fatkeqësive.

8.1.1. Performanca: Hardueri dhe softueri duhet të shqyrtohen së bashku për sa i përket aftësisë së tyre për të kryer detyrat e nevojshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit. Sistemet duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë që të dhënat të mund të futen lehtë dhe shpejt, të azhurnohen, klasifikohen dhe gjenden. Sistemet softuerike duhet të plotësojnë kërkesat e programit të sigurimeve, duke përfshirë futjen e të dhënave dhe dokumentacionit, vlerësimin, klasifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë. Përveç kësaj, masat e sigurisë duhet të jenë një komponent qendror i sistemeve informative të menaxhimit. Sistemet harduerike dhe softuerike duhet të parashikojnë rritjen dhe ndryshimet në të ardhmen. Elementet harduerike dhe softuerike të programit do të duhet të lejojnë ndryshime të tilla, pasi që zhvillohen produkte dhe procedura të reja.

8.1.2. Kostot: Shumica e kostove të sistemeve harduerike dhe softuerike janë të fiksuara. Prandaj, vendimet lidhur me performancën duhet të krahasohen me shpenzimet fillestare të kapitalit. Megjithatë, është e rëndësishme të zgjidhen sisteme që mund të zgjerohen me shpenzime minimale kur pritet rritja e programeve. Përveç kësaj, kostot e modifikimit të softuerit për produkte të reja shpesh nënvlerësohen. Rrjedhimisht, është e rëndësishme që programet e zgjedhura softuerike të jenë fleksibile në pritje të ndryshimeve në të ardhmen.

8.1.3. Kapaciteti i ruajtjes: Nevojat për kapacitetin e ruajtjes janë në fund të fundit një funksion i sasisë së të dhënave që do të procesohen dhe ruhen. Është e rëndësishme të përzgjidhen sistemet që jo vetëm përbushin nevojat aktuale, por gjithashtu mund të zgjerohen pa pengesa për të përbushur nevojat në të ardhmen. Mund të jetë e vështirë të azhurnohen kapacitetet e ruajtjes nëse sistemet nuk janë konfiguruar mirë në fillim.

Përzgjedhja e vetive të kapacitetit të ruajtjes, duke përfshirë hapësirën e ruajtjes dhe kujtesën interne, ndikohet edhe nga kompleksiteti i karakteristikave të kërkuara dhe sasia e aktivitetit që lidhet me futjen e të dhënave dhe qasjen në to.



8.1.4. Varshmëria: Sistemet harduerike dhe softuerike duhet të jenë të besueshme dhe të kenë përkrahje adekuatë nga prodhuesi. Sistemet duhet të kenë një histori të performancës së mirë pa pasur nevojë për ndërprerje të shpeshta të shkaktuara nga azhurnimet dhe modifikimet. Gabimet që bëhen gjatë futjes së të dhënave ose qasjes duhet të identifikohen nga softueri dhe nuk duhet të shkaktojnë që një sistem të ndalë funksionimin. Kapacitetet dhe aftësitë e harduerit dhe softuerit duhet të analizohen hollësisht para blerjes. Aftësia për të marrë përkrahjen e vazhdueshme të prodhuesit dhe garancitë e zgjeruara mund të zvogëlojë shpenzimet e ardhshme operacionale.

8.1.5. Kopja rezervë dhe rikthimi pas fatkeqësive: Sistemet harduerike dhe softuerike duhet të kopjohen pa pengesa dhe vazhdimisht në dy vende në lokacion dhe jashtë lokacionit. Sistemet e kopjes rezervës duhet të kenë identifikues konsistentë dhe të dukshëm të kontrollit të versioneve. Kopjet rezervë brenda lokacionit janë të rëndësishme për korrigjimin ose rikthimin e problemeve të vogla të futjes së të dhënave dhe janë me rëndësi kritike për kontrollin e versioneve. Mekanizmat e përkrahjes jashtë lokacionit janë veçanërisht të rëndësishme për rikthimin pas fatkeqësive që mund të shkaktohen nga dëmtimi i pajisjeve lokale harduerike ose shkeljet e sigurisë.

Qasja në të dhëna nuk duhet të pengohet gjatë mirëmbajtjes së harduerit dhe softuerit ose gjatë azhurnimit të të dhënave.

9.0 Përmbledhja

Programet e sigurimeve bujqësore janë sisteme komplekse biznesi që kërkojnë koordinim ndërmjet shumë njësive. Pjesa më e madhe e këtij koordinimi përfshin menaxhimin e informacionit dhe të dhënave. Megjithëse dizajni i programit, menaxhimi dhe zhvillimi i produkteve kërkojnë shumë të dhëna, vlerësimi strategjik i menaxhimit të të dhënave shpesh merr prioritet të ulët.

Sidoqoftë, mundësia e realizimit dhe suksesi i programeve të sigurimeve bujqësore varet në mënyrë kritike nga mbledhja dhe menaxhimi i të dhënave për vlerësimin, nënshkrimin e sigurimit, shitjen, kompensimet, subvencionet dhe risigurimet. Për shkak se kërkesat për të dhëna për zhvillimin e produktit dhe operacionet e programit nuk janë vetëm voluminoze, por edhe shpesh ndahen ndërmjet palëve të interesuara, është me rëndësi kritike që pajisjet kompjuterike harduerike, softuerike, dhe sistemet e kopjes rezervë të zhvillohen për të mbajtur kostot e menaxhimit të të dhënave të ulëta, që të mund të zgjerohen, të sigurohet fleksibiliteti, të ketë kopje rezervë të mjaftueshme dhe të jenë të sigurta. Programet e sigurimeve bujqësore nuk duhet të zhvillohen pa një plan strategjik të hollësishëm që trajton nevojat për të dhëna, disponueshmërinë dhe menaxhimin.



Informatat e kontaktit:
International Finance Corporation
2121 P ennsylvania avenue, NY
Washington, DC 20433, USA
www.ifc.org

